

Ky vëllim *"Dokumente për Historinë e Shqipërisë (1623-1653)"* ndjek ata të mëparshmit e kësaj serie, dm.th: dy pjesët e periudhës 1479-1506 (pjesa e parë 1479-1499, Tiranë 1967; pjesa e dytë 1499-1506, Tiranë 1979), dhe tre vëllimet që ndjekin: 1507-1592, 1593-1602, 1603-1621.

Në ndryshim nga të mëparshmit, të cilët përbëhen kryesisht nga dokumente të botuara më parë në bibliografinë e shekujve XIX-XX dhe janë me karakter politik-administrativ, si edhe me karakter socio-gjeografik, ky vëllim rezulton i përbërë në pjesën më të madhe nga dokumente të pabotuara (rreth 75 përqind) të cilat ne i kemi transkriptuar nga riprodhimet fotografike të nxjerra nga fondet e ndryshme të Arkivit të Propaganda Fides, që kanë një përmbajtje të veçantë.

*Injac Zamputti*

*Albanisches Institut* në St. Gallen ka pranuar me shumë dëshirë që të botojë librin e Injac Zamputtit *"Dokumente për Historinë e Shqipërisë (1623-1653)"*. Injac Zamputti është shumë i respektuar në qarqe shkencore, sidomos historike, por edhe etnografike, kulturore, letrare jo vetëm në Shqipëri e Kosovë, por edhe më gjerë. Këtë respekt gëzon Zamputti për shkak të punës dhe veprimtarisë së tij të zellshme dhe serioze e cila e përcolli tërë jetën e tij. Në kohën e regjimit komunist, ai punoi në kushte shumë të vështira, por serioziteti dhe përkushtimi ndaj shkencës, bëri që historiografia shqiptare të përparojë shumë përmes botimeve të tija, mbase lirisht mund të thuhet se Zamputti ishte shtylla kryesore në Shqipëri që historiografia e mesjetës shqiptare, në kohën e diktaturës komuniste, të mos jetë vetëm ideologjike. Opusi i Zamputtit është i gjerë, kur shofim listën e publikimeve të tija. Duhet pasur parasysh se përgatitja e tij serioze akademike bëri që ai të „zhjyhet“ në botën e shkencës, duke filluar në vendlindjen e tij në Shkodër, për ta mbyllur në Itali.

*Albert Ramaj*

ISBN 978-3-9524201-4-0  
ISBN 978-9951-06-550-4

DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1623-1653)

# DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1623-1653)

## DOCUMENTI PER LA STORIA DELL' ALBANIA 1623-1653

Transkriptuar e përkthyer nga  
Trascritti e tradotti da

**Injac Zamputti**

albanisches  
institut

FAIK KÖNICA



DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1623 – 1653)  
TRANSKRIPTUAR E PËRKTHYER NGA INJAC ZAMPUTTI

DOCUMENTI PER LA STORIA DELL'ALBANIA (1623 – 1653)  
TRASCritti E TRADOTTI DA INJAC ZAMPUTTI

albanisches  
institut

FAIK KONICA

St. Gallen-Prishtinë  
2015

DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1623-1653),  
Transkriptuar e përkthyer nga INJAC ZAMPUTTI  
DOCUMENTI PER LA STORIA DELL'ALBANIA (1623-1653  
Trascritti e tradotti da INJAC ZAMPUTTI

Përgjegjës të këtij botimi:

Jozef Zamputti, Albert Ramaj, Nazmi Rrahmani e Zef Ahmeti

© Albanisches Institut

albanisches  
institut

**Albanisches Institut**

Postfach 7, CH-9001 CH-St. Gallen

[www.albanisches-institut.ch](http://www.albanisches-institut.ch)

[info@albanisches-institut.ch](mailto:info@albanisches-institut.ch)

FAIK KONICA

**Faik Konica**

Rr. Ganimete Tërbeshti nr. 20

10000 Prishtinë

[konica\\_faik@hotmail.com](mailto:konica_faik@hotmail.com)

(CIP) Schweizerische Landesbibliothek  
ISBN 978-3-9524201-4-0

(CIP) Biblioteka Kombëtare e Kosovës  
"Pjetër Bogdani"  
ISBN 978-9951-06-550-4

# DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1623-1653)

Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputti

## DOCUMENTI PER LA STORIA DELL' ALBANIA 1623-1653

Trascritti e tradotti da Injac Zamputti



Përgatitur për shtyp sipas dorëshkrimeve nga i biri i autorit,  
***Jozef Zamputti***

*Shënim:* Jemi përpjekur të mos bëjmë gabime gjatë hedhjes së materialit nga dorëshkrimi në kompjuter, por, me gjithë kontrollin tonë edhe gjatë përgatitjes për shtyp, mund të ketë gabime. Kur lexuesi të ketë ndonjë dyshim, mund të na sinjalizojë në adresën: [jozef\\_zamputti@yahoo.it](mailto:jozef_zamputti@yahoo.it) dhe ne e kontrollojmë me dorëshkrimin e autorit - **J.Z.**

## Përmbajtja

|   |     |
|---|-----|
| Parafjala e botuesit nga Albert Ramaj.....  | 7   |
| Parathënie.....   | 9   |
| Dokumente për historinë e Shqipërisë 1623 – 1653.....                                   | 11  |
| Lista e dokumenteve.....  | 11  |
| Documenti per la storia dell’Albania 1623 - 1653.....                                   | 30  |
| Elenco dei documenti.....   | 30  |
| Dokumente vetëm të transkriptuara e të papërkthyer.....                                 | 456 |
| Documenti solo trascritti e non tradotti.....   | 456 |
| Listë për disa çështje e të dhëna të pasqyruara në dokumentacionin e këtij vëllimi..... | 519 |
| Treguesi i emrave.....  | 528 |
| Burimi arkival dhe bibliografia.....  | 564 |
| Jetëshkrim i Injac Zamputtit.....   | 566 |
| Bibliografia e Injac Zamputtit.....   | 569 |

## **Shënim nga autori mbi dosjen e dorëshkrimeve:**

*Ky vëllim është ndërtuar si plotësim i dy vëllimeve të mija RELACIONE etj.*

*-Ka, prandaj, materiale të reja të transkriptuara e të përkthyer prej meje të njëkohëshme me ato të Relacioneve.*

*-Ka, në rendin kronologjik, edhe materiale burimore me prejardhje të ndryshme.*

*-Kam edhe materiale të tjera nga A.Pr.F. të transkriptuara më vonë që mund të futen në këtë vëllim.<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> Shënim J. Z. – Këto materiale të transkriptuara e të papërkthyer janë vendosur në fund. Në vazhdim të vëllimeve të tjera me dokumente, botuar më parë, autori për fjalët *vescovo*, *arcivescovo* etj. në përkthim përdor fjalët *peshkop*, *kryepeshkop* etj. Kuptohet se mund të përdoren fare mirë fjalët *ipeshkëv*, *argjipeshkëv* etj.

## Parafjala e botuesit

Albanisches Institut në St. Gallen ka pranuar me shumë dëshirë që të botojë librin e Injac Zamputtit "Dokumente për Historinë e Shqipërisë (1623-1653)". Injac Zamputti është shumë i respektuar në shumë qarqe shkencore, sidomos historike, por edhe etnografike, kulturore, letrare jo vetëm në Shqipëri e Kosovë, por edhe më gjerë. Këtë respekt gëzon Zamputti për shkak të punës dhe veprimtarisë së tij të zellshme dhe serioze e cila e përcolli tërë jetën e tij. Në kohën e regjimit komunist, ai punoi në kushte shumë të vështira, por serioziteti dhe përkushtimi ndaj shkencës, bëri që historiografia shqiptare të përparojë shumë përmes botimeve të tija, bile lirisht mund të thuhet se Zamputti ishte shtylla kryesore në Shqipëri që historiografia e mesjetës shqiptare, në kohën e diktaturës komuniste, të mos jetë vetëm ideologjike. Opusi i Zamputtit është i gjerë, kur shofim listën e publikimeve të tija. Duhet pasur parasysh se përgatitja e tij serioze akademike bëri që ai të „zhjyhet“ në botën e shkencës, duke filluar në vendlindjen e tij në Shkodër, për ta mbyllur në Itali. Në Shkodër, saktësisht në kolegjin Saverian, ku ishte formuar Zamputti në kohën e rinisë së tij, kishte mësimdhënëse shumë të mirë; këtu po çek vetëm dy: Dom Ndre Mjedja dhe Giuseppe (Zef) Valentini. Qysh në kohën 21 vjeçare Zamputti ligjëron letërsinë shqipe në Kolegjin Saverian në krah të Dom Ndre Mjedjes, kurse mësimet që mori nga Giuseppe Valentini ishin mbresëlënëse për tërë jetën e Zamputtit. Valentini ishte mësuesi i tij për leximin e dokumentacionit për historinë shqiptare. Me Valentinin nuk mundi të takohej më pas përfundimit të luftës së dytë botërore, sepse Valentini gjendej tashmë në Itali, kurse Zamputti në Shqipëri, por njëri (Valentini) në anën tjetër të Adriatikut vepronte më përkushtim për historinë shqiptare, e tjetri (Zamputti) në anën tjetër dhe me të njejtën frymë europiane - edhe pse nuk e lejonin të shkonte nëpër arkiva të Europës. Injac Zamputti mbeti në Shqipëri dhe iu përkushtua tërësisht shkencës, konkretisht historisë shqiptare të mesjetës dhe me botimet e veta arriti që ato vepra të mbesin edhe sot kryevepra historiografike dhe burime kryesore historike të asaj periudhe.

Librin e Zamputtit „Dokumente për Historinë e Shqipërisë (1623-1653)“, që kishte lënë në dorëshkrim dhe që është vazhdim i serisë së vëllimeve me dokumente të botuara prej tij, po e botojmë me kënaqësi dhe lirisht mund të themi edhe me krenari. Ky libër është shumë i rëndësishëm për historinë shqiptare, pikërisht për vitet e lartëshënuara 1623-1653, sepse Zamputti lexon, transkripton dhe përkthen dokumente të rëndësishme, që janë ende të panjohura për studjuesit shqiptarë dhe që



i pajis me shënime e lista vendesh e njerëzish. Për veprën dhe rëndësinë e saj nuk do të flasim këtu, pasi këtë gjë mund ta vlerësojë vetë lexuesi.

Për botimin e kësaj vepre, falenderojmë të birin e autorit, Jozef Zamputtin, i cili na ofroi këtë botim dhe i cili me zell të madh përgatiti për shtyp këtë vepër që babai i tij kishte lënë në dorëshkrim dhe nuk kishte arritur që ta botonte deri sa ishte gjallë. Po ashtu falenderoj shtëpinë botuese Faik Konica, që, me shumë dëshirë, pranoi të jetë bashkëbotuese e këtij libri.

Kjo vepër ishte paraparë që të botohet qysh më parë, me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Injacit, por, kjo nuk u realizua.

Pas bisedimeve edhe me Jozefin, e pamë të arsyeshme që, në fund të kësaj vepre, të botojmë jetëshkrimin e Injac Zamputtit (përgatitur nga vetë Jozefi) dhe po ashtu është shumë e rëndësishme për studjuesit botimi i bibliografisë së Injac Zamputtit, që kishte përgatitur vetë ai ditët e fundit të jetës së tij dhe që po e sjellim në fund të librit.

Pjesërisht shpenzimet për këtë botim, i mbuloi autori i këtyre rreshtave me shumë dëshirë, duke njohur dhe respektuar punën e palodhshme të Injac Zamputtit.

**Albert Ramaj**

## Parathënie

Ky vëllim “Dokumente për Historinë e Shqipërisë (1623-1653)” ndjek ata të mëparshmit e kësaj serie, dm.th: dy pjesët e periudhës 1479-1506 (pjesa e parë 1479-1499, Tiranë 1967; pjesa e dytë 1499-1506, Tiranë 1979), dhe tre vëllimet që ndjekin: 1507-1592, 1593-1602, 1603-1621.

Në ndryshim nga të mëparshmit, të cilët përbëhen kryesisht nga dokumente të botuara më parë në bibliografinë e shekujve XIX-XX dhe janë me karakter politik-administrativ, si edhe me karakter socio-gjeografik, ky vëllim rezulton i përbërë në pjesën më të madhe nga dokumente të pabotuara (rreth 75 përqind) të cilat ne i kemi transkriptuar nga riprodhimet fotografike të nxjerra nga fondet e ndryshme të Arkivit të Propaganda Fides, që kanë një përmbajtje të veçantë.

Periudha e pasqyruar në këtë vëllim, e përfshirë ndërmjet vitit 1623 dhe vitit 1653, karakterizohet, për Shqipërinë Veriore, duke përfshirë edhe Kosovën, dhe për Shqipërinë Qendrore, nga një veprimtari intensive e kishës katolike e cila, e mundur në Veriun europian, e ktheu vemendjen e saj politike, përveçse drejt Amerikës Latine e gjetkë, edhe drejt vendeve të Jug-Lindjes europiane të pushtuara nga Perandoria Otomane. Kjo veprimtari, që synonte të rivendoste pozicionet e kishës katolike në vendin tonë, u udhëhoq nga Kongregacioni i Propaganda Fides, duke përfshirë klerin e vendit e duke themeluar misione me fretërit françeskanë italianë. Kështu, plagës së mëparshme të prelatëve sllavë që Roma dërgonte si titullarë të disa dioçezeve dhe abacive në Shqipëri, iu shtua tjetra e misionarëve italianë. Në këtë mënyrë, konfliktit të ndezur midis klerit vendas shqiptar dhe prelatëve sllavë, iu shtua edhe një tjetër.

Rrjedh se dokumentet e nxjerra nga Arkivi i Propaganda Fides trajtojnë kryesisht çështjet kishtare e misionare ku, në mënyrë të qartë, pasqyrohen edhe konfliktet e çekura më lart.

Në veprimtarinë tonë të kërkimeve në bibliografinë e mëparshme nuk kemi ndeshur, për këtë periudhë, kaq shumë materiale që pasqyrojnë ngjarjet politike, të një sasive kaq të madhe sa në vëllimet tona të mëparshme. Pjesa më e madhe e dokumenteve, të zbuluara, të mbledhura e të sistemuara, janë të Arkivit të Propaganda Fides.

Më parë dhe pavarësisht nga kjo seri, kemi botuar dy vëllime të tjera: “Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII”, vëllimi I (1610-1634), Tiranë 1963; vëllimi II (1634-1650), Tiranë 1965.

Ky vëllim, pra, 1623-1653, është, në pjesën më të madhe, plotësuesi i natyrshëm i këtyre dy vëllimeve. Në fakt, rreth 75 përqind e dokumenteve të këtij vëllimi janë të së njëjtës natyrë e prejardhje të atyre që kemi botuar në dy vëllimet e mësipërme.

Për të pasur një kuadër të plotë, kemi menduar të japim, para materialeve dokumentare, një listë kronologjike, duke përfshirë, por vetëm për referim, edhe kokat e dokumenteve të botuara në dy vëllimet e mëparshme.

Në këtë listë do të shihet:

Cilat janë dokumentet e botuara më parë në dy vëllimet e së njëjtës periudhë e që, në këtë listë, janë kujtuar thjeshtë në rendin e tyre kronologjik. Kështu, në listë, këto dokumente, nuk kanë numrin rendor. Pranë, si referim, japim në kllapa siglën REL., për të treguar vëllimin dhe numrin përkatës që ato kanë në vëllimet e çekura më lart.

Për disa pak nga këto, kemi nxjerrë ato përmbledhje dhe ato pjesë që na u dukën me interes më të madh për të dhënë, edhe në këtë vëllim, një kuadër sa më të qartë të çështjeve të natyrës kishtare të periudhës. Në këto raste dokumentit i është vënë numër dhe është përfshirë në vëllim.

*Injac Zamputti*

---

## DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË 1623 – 1653

### Lista e dokumenteve

*Shënim:* Dokumentet e mëposhtëm në rend kronologjik paraqiten me numër rendor ose pa numër. **Me numër** - Janë dokumentet e riprodhuara në këtë vëllim.

**Pa numër** – Kujtohen dokumentet e botuara nga ne në botimin RELACIONE etj. e që renditen këtu vetëm nëse duhen përdorur si dhe për të plotësuar rendin kronologjik.

\*\*\*

**1 - 1623 shkurt 1** – Domenik Andreasi, peshkop i zgjedhur i Shkodrës, duke u gjetur në Raguzë në udhëtim për të ardhur në seli, i shkruan Kardinalit Barberini për ta njoftuar në lidhje me veprimin e Pjetër Budit kundër ardhjes së prelatëve të huaj e për ta lajmëruar gjithashtu për vdekjen e tij si pasojë e mbytjes.

**1623 shkurt 28** – Letër e peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, drejtuar Kongregacionit të Pr.F., me të cilën lajmëron për vdekjen e Pjetër Budit dhe porosin të emërohet një titullar tjetër për Zadrimën (REL. I/7).

**2 - 1623 mars 8** – Domenik Andreasi, duke kujtuar vdekjen e Pjetër Budit, porosin që, në selinë e Zadrimës, të emërohet Gjeci (Gjergj) Bardhi.

**3 - 1623 mars** – Benedikt Orsini na jep datën e saktë të vdekjes së Pjetër Budit si pasojë e mbytjes.

**4 - 1623 prill 21** – Në karakteristikat që i jepen Papës për Gjergj Bardhin për ta emëruar peshkop në Zadrimë, del edhe dyshimi se ai ka pasur gisht në vdekjen e Pjetër Budit.

**1623 qershor 4** – Letër e peshkopit të Shkodrës, Domenik Andreasi, drejtuar një prelati me të cilën përcjell relacionin e vet dhe kërkon subsidin (REL. I/11).

**1623 qershor 4** – Relacion i peshkopit të Shkodrës, Domenik Andreasi, drejtuar Kongregacionit të Pr.F. mbi vizitën e bërë prej tij në dioqezën e vet (REL. I/12).

**1623 korrik 1** – Letër e Vizitorit Apostolik, shqiptarit Pjetër Mazrreku, drejtuar një prelati, në të cilën flet për vizitën e vet në Bullgari dhe gjetkë dhe lajmëron vdekjen e peshkopit të Sofjes (REL. I/13).

**5 - 1623 tetor 25** – Domenik Andreasi, duke folur për vështirësitë që ka ndeshur në dioqezën e vet të Shkodrës, ia vë fajin sinodit të mbledhur më parë prej Pjetër Budit që synonte të pengohej emërimi i prelatëve të huaj.

**1623 tetor 26** – Letër e tetë priftërinjve të dioqezës së Shkodrës drejtuar Kongregacionit të Pr.F. me të cilën mbrojnë peshkopin e tyre (REL. I/15).

**6 - 1623/1624** – Pjetër Mazrreku, Vizitor Apostolik, informon se Prizreni e Shkupi janë qytete të banuara në pjesën më të madhe prej myslimanësh shqiptarë. Pastaj e dënon zakonet që të emërohen peshkopë të huaj në Shqipëri.

**1624 janar 20** – Letër e kryepeshkopit të Raguzës drejtuar Kardinalit Ludovizi në lidhje me shumën e të hollave që i është dërguar për llogari të Pjetër Mazrrekut (REL. I/17).

**7 - 1624 korrik 13** – Venediku i jep udhëzime qeverisë së Korfuzit për tregtinë e grurit.

**8 - 1624 shtator 27** – Venediku lajmëron Proveditorin e Përgjithshëm të Dalmatisë e Shqipërisë mbi projektin e spanjollëve për të mbledhur ushtarë dhe për të transferuar qindra familje dalmatine e shqiptare në Spanjë, në vendet që ishin të maurëve.

**9 - 1624 tetor 13** – Peshkopi i Zadrimës propozon që të hapet një shkollë në Shqipëri.

**1624** – Pjesë nga një relacion i peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, në lidhje me vrasjen e priftit shqiptar, Dom Mark Kishanjit (REL. I/19).

**1625 prill 20** – Letër e peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, drejtuar një prelati në Romë, me të cilën shpreh keqardhjen për humbjen e relacionit të tij dhe dërgon një tjetër (REL. I/20).

**1625 maj 15** – Letër e kryepeshkopit të Tivarit, Pjetër Mazrreku, drejtuar një prelati në Romë, me të cilën justifikon kërkesat e veta për të holla (REL. I/21).

**1625 maj 24** – Letër e Benedikt Orsinit drejtuar një prelati në Romë. Referon për disa çështje të dioqezës së vet të Lezhës dhe ankohet sidomos për sjelljen e peshkopit të Arbërisë, Gjon Kolesi, dhe të fretërve (REL. I/22).

**1625 korrik 15** – Kryepeshkopi i Tivarit, Pjetër Mazrreku, i shkruan Kongregacionit të Pr. F. duke i kërkuar subsid që të mund të kryejë vizitën në dioqezën e vet (REL. I/23).

**10 - 1625** – Relacion i peshkopit të Arbërisë, Gjon Kolesi, drejtuar Kongregacionit të Pr.F. në lidhje me dioqezën e vet.

**11 - 1626 prill 11** – Senati venedikas porositi Proveditorin e Kotorrit që të mos pengohet transporti i grurit që raguzanët tërheqin nga limanet e Shqipërisë.

**12 - 1626 qershor 23** – Senati venedikas lavdëron veprimin e Proveditorit të Përgjithshëm të Dalmatisë e Shqipërisë për masat që ka marrë në lidhje me murtajen që po përhapet në Shqipëri.

**13 - 1626 tetor 15** – Në senatin venedikas propozohet që të lehtësohet blerja e pëlhurave nga ana e raguzanëve të cilët, në rast të kundërt, i blejnë gjetkë ose i nxjerrin kontrabandë dhe pastaj i shesin në Durrës, Vlorë etj.

**14 - 1627 qershor 25** – Senati venedikas vendos që të merren masa për të ndaluar mbledhjen e ushtarëve shqiptarë etj. për repartet e dukës Valenshtajn.

**15 - 1627 korrik 1** – Sulltan Jaho, duke parë se tashmë përpjekjet e tij janë venitur, i drejtohet princit të Toskanës duke i blatur përpjekjet e tij të fundit nëqoftëse ai princ do të dojë ta marrë përsipër ndërmarrjen në Ballkan.

**1628 prill 27** – Letër proteste e klerit të Shkodrës drejtuar në Romë, me të cilën ankohet kundër kryepeshkopit të Tivarit dhe kundër peshkopit të Zadrimës, në lidhje me çështjet e juridiksionit kishtar (REL. I/25)

**1628 qershor 20** – Relacion i klerit të Shkodrës dhe besimtarëve të Barbullushit drejtuar Papës dhe Kongregacionit të Pr.F. për çështjen e kishës së Barbullushit (REL. I/26).

**1628 qershor 20** – Letër e peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, drejtuar Kongregacionit të Pr.F. në lidhje me konfliktin që ai ka me kryepeshkopin e Tivarit për kishën e Barbullushit (REL. I/27).

**1628 qershor 20** – Relacion i klerit të Shkodrës drejtuar Selisë Apostolike në lidhje me konfliktin për çështjen e kishës së Barbullushit (REL. I/28).



**16 - 1628 gusht 31** – Nga një relacion i vizitës së bërë nga Benedikt Orsini në malet e Shkodrës: gjendja dhe mbishkrimi në kishën e manastirit të Shën Gjonit të zonës së Drishtit.

**17 - 1629 tetor 12** – Venediku jep udhëzime që t'u lejohet raguzanëve nxjerrja e grurit nga Vlora, por vetëm për përdorim të tyre dhe t'u ndalohej dërgimi në vende të tjera.

**1629** – Relacion i peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, drejtuar Kongregacionit të Pr.F. në lidhje me vizitën e bërë në dioqezën e Shkodrës (REL. I/30).

**1629** – Relacion i po atij mbi famullitë dhe çështje të tjera të dioqezës së vet të Lezhës (REL. I/31).

**18 - para vitit 1630** – Një pasqyrë përmbledhëse e vendeve shqiptare që nuk i janë nënshtruar zotërimit turk me numrin përkatës të familjeve.

**1630(?)** – Tetë dëshmi të mbledhura kundër vikarit të përgjithshëm të Tivarit, D.Pjetër Samuelli, në lidhje me konfliktet që ai ka pasur me familjen Paskuali (REL. I/33).

**19 - 1631/1632** – Lajme për shiun prej hiri që ka rënë në bregun lindor të Adriatikut ardhur nga shpërthimi i Vezuvit.

**1632 shkurt 24** – Relacion i peshkopit të Zadrimës, Gjergj Bardhi, dhënë Kongregacionit të Pr.F. për vizitat dioqezane të viteve 1629-1631 (REL. I/34).

**1632 mars 20** – Nga letra e peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, drejtuar një prelati në Romë, për çështje personale dhe për ankesat e popullsisë së Pultit kundër një prifti (REL. I/35).

**1632 mars 20** – Përmbledhje nga një relacion i po atij në lidhje me përndjekjet e pësura prej priftit të Pëdhanës (REL. I/36).

**20 - 1633 prill 1** – Venediku pengon ngarkesën e valanidheve në brigjet e Shqipërisë dhe të Moresë që të çohen në vende të tjera dhe jo të Venedikut.

**21 - 1633** – Pjesë nga relacioni i Pjetër Mazrrekut ku, në mënyrë të veçantë, flitet për zonat malore të Shqipërisë së Veriut. Në fund edhe fjalorthi italisht-shqip.

**1634 tetor 25** – Letër e Nikolla Nasakit drejtuar një prelati, me të cilën ankohet për veprimet e vikarit të Tivarit (REL. I/38).

**22 - 1634 dhjetor 9** – Një grup misionarësh bëjnë dëshmi se nuk kanë mundur të hyjnë në Shqipëri sepse kanë ndeshur shumë kundërshtime ndërsa po prisnin në Raguzë. Prandaj, duke ua lënë vetëm dy misionarëve këtë detyrë, ata kthehen mbrapa.

**23 - 1634 dhjetor 12** – Venediku jep urdhra që të pengohet shkuarja e ushtarakëve himariotë në shërbim të spanjollëve, siç ka ndodhur kohët e fundit me rreth 400 veta që kanë shkuar.

**1634** – Relacion i peshkopit të Zadrimës, Gjergj Bardhi, për vizitën e bërë prej tij në malet e Dukagjinit, Pultit e Kelmendit (REL. I/39).

**1634** – Pjesë nga relacioni i prefektit të misioneve në Shqipëri, P. Bonaventura nga Palacolo, drejtuar Kongregacionit të Pr. F. ku bëhet fjalë për gjendjen në malet e Pultit (REL. II/1 – Shënim: Kjo pjesë është plotësuese e relacionit të vitit 1635, maj-qershor, fl. 16v-17; të shihet më tutje Dok. Nr. 27).

**24 - 1635 maj 9** – P. Bonaventura nga Palacolo i shkruan një kardinali në Romë në lidhje me përvojat e para misionare të veta dhe të shokut të vet në misionin e Shqipërisë.

**25 - 1635 maj 12** – P. Bonaventura nga Palacolo i shkruan imzot Ingolit në Romë rreth punës së vet dhe të shokut të vet në Shqipëri, në këto kohë të fillimit të misionit.

**26 - 1635 maj 17** – P. Bonaventura nga Palacolo i shkruan imzot Ingolit në lidhje me vendosjen e misioneve në Zadrimë dhe me marrëdhëniet që ka me peshkopin e vendit, Gjergj Bardhin.

**27 - 1635 maj-qershor** – Relacion i P. Bonaventura nga Palacolo dërguar në Romë, në të cilin jepen hollësira për vendosjen e misioneve në Shqipëri dhe për veprën e misionarëve në këtë fillim të veprimtarisë së tyre. Flitet për vështirësitë e ndeshura, për nevojat që ato misione të funksionojnë mirë, për gjendjen e popullsisë, si të atyre që nuk i janë nënshtruar shfrytëzimit osman, si të atyre që i janë nënshtruar etj.

**28 - 1636 shkurt 11** – Një grup klerikësh dhe shekullarësh dëshmojnë se famullitë e Mirditës, të cilat pretendohen nga peshkopi i Lezhës, përherë i kanë përkitur peshkopatës së Arbërisë.

**29 - 1636 mars 24** – Dëshmi e disa famullitarëve të Mirditës në lidhje me përkatësitë juridiksionale të peshkopatës së Arbërisë.

**1636 prill 19** – Letër e peshkopit të Arbërisë, Mark Skura, drejtuar imzot Ingolit, me të cilën trajton çështje të juridiksionit kishtar dhe të konfliktit ndërmjet tij dhe peshkopit të Lezhës (REL. II/2).

**30 - 1636 maj 8** – Misionari fra Kerubino i shkruan peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, duke u shfajësuar se nuk mund të shkojë te ai peshkop, siç i është kërkuar, dhe duke i shpjeguar se ai vetë është dorëjashtë në konfliktin juridiksional ndërmjet Lezhës e Zadrimës.

**31 - 1636, pas 8 majit** – Benedikt Orsini proteston kundër mbledhjes që është bërë me urdhrin e kryepeshkopit të Tivarit me synim që të lëvizen kufijtë dioqezanë.

**1636 qershor 4** – Letër e kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, drejtuar Kardinal Antonit, në lidhje me konfliktin për juridiksion ndërmjet peshkopit të Lezhës dhe atij të Arbërisë (REL. II/3).

**32 - 1636 qershor 8** – Benedikt Orsini, në një shënim dërguar famullitarit të Ndërfandës, pohon se ka pëlqimin e Romës për sa ka bërë ai në ato vise.

**33 - 1636 qershor 12** – Peshkopi i Arbërisë i referon Romës për çështjen e juridiksionit dioqezan dhe për ndërhyrjet e peshkopit të Lezhës.

**1636 shtator 7** – Letër e peshkopit të Zadrimës, Frang Bardhi, drejtuar imzot Macoldit, në të cilën tregon për pritjen që i kanë bërë me të arritur në seli dhe për nevojën që ka vendi që të ketë njerëz të ditur etj. (REL. II/4).

**1636 shtator 8** – Letër e kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, drejtuar imzot Ingolit, për çështje të vizitës së tij baritore, për konfliktin që është në Shqipëri në lidhje me juridiksionin kishtar dhe për nevojën që të përgatitet kleri (REL. II/5).

**1636 shtator 8** – Letër e po atij drejtuar Kongregacionit të Pr. F. po për konfliktin e juridiksionit kishtar ndërmjet dioqezave të Lezhës e të Arbërisë (REL. II/6).

**1636 shtator 8** – Letër e peshkopit të Zadrimës, Frang Bardhi, drejtuar imzot Ingolit, me të cilën referon për arritjen e vet në seli dhe për nevojat e dioqezës së vet (REL. II/7).

**1636 tetor 27** – Letër e peshkopit të Arbërisë, Mark Skura, drejtuar imzot Ingolit, me të cilën referon për arritjen e vet në seli dhe për pagesat që i është dashur të bënte për zotërit e vendit etj. Trajton edhe pretendimet e peshkopit të Lezhës në lidhje me juridiksionin kishtar (REL. II/8).

**1636 nëntor/dhjetor** – Letër e kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, drejtuar imzot Ingolit, me të cilën i referon për vizitën e bërë nëpër dioqezë dhe trajton çështje të ndryshme personale (REL. II/9).

**1636 dhjetor 22** – Letër e peshkopit të Arbërisë, Mark Skura, drejtuar imzot Ingolit, me të cilën kërkon subsid, ankohet kundër peshkopit të Lezhës dhe tregon veprimtarinë e vet (REL. II/10).

**1636 dhjetor 22** – Dëshmi e lëshuar prej peshkopit të Arbërisë, Mark Skura, për të mbështetur kërkesat e priftit Gjon Bogdani, i cili dëshiron të ndërtojë një kishë (REL. II/11).

**1636 dhjetor 31** – Letër e kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, drejtuar një prelati në Romë për disa çështje të administratës kishtare (REL. II/12).

**1636 dhjetor 31** – Po ai shkruan në Romë për disa çështje të administratës dhe për juridiksionin kishtar (REL. II/13).

**1636 dhjetor 31** – Po ai i shkruan Kongregacionit të Pr. F. në lidhje me vizitën që ka bërë në dioqezën e vet të Serbisë (Kosovë) (REL. II/14).

**1636 dhjetor 31** – Po ai jep një relacion drejtuar Kongregacionit të Pr. F. në lidhje me veprimet e padrejta të peshkopit të Lezhës dhe me konfliktin për kishën e Barbullushit (REL. II/15).

**34 - 1636** – Një tjetër relacion i P. Bonaventura nga Palacolo në lidhje me ecurinë e veprimtarive misionare në Shqipëri, ashtu edhe në lidhje me luftat e zonave të lira malore të Veriut kundër ekspeditave të ushtrive të sanxhakbejlerëve.

**35 - 1636(?)** – Përmbledhje e një relacioni të peshkopit të Zadrimës, Frang Bardhi, në lidhje me popullsitë malore e mundësinë për të marrë Lezhën, Shkodrën etj.

**36 - 1636(?)** – Prefekti i misionëve, P. Bonaventura nga Palacolo, i jep hollësira Papës për çështjet shpirtërore të vendeve të misionit duke fajosur peshkopët dhe klerin për shumë lëshime kundër normave katolike.

**37 - 1637, fillim** – Peshkopi i Zadrimës, Frang Bardhi, i jep përgjigje Komisarit Apostolik në lidhje me pretendimet e padrejta të peshkopit të Lezhës për juridiksionin e Blinishtit.

**38 - 1637, fillim** – Peshkopi i Zadrimës, Frang Bardhi, i shkruan Kongregacionit të Pr. F. në lidhje me juridiksionin e dioqezës së Zadrimës dhe akuzon peshkopin e Lezhës për ndërhyrjen e tij.

**1637 janar 20** – Letër e peshkopit të Arbërisë, Mark Skura, drejtuar një prelati në Romë për disa çështje të administratës kishtare (REL. II/16).

**39 - 1637 shkurt 8** – Letër e Frang Bardhit drejtuar imzot Ingolit. Trajton çështje të ndryshme dioqezane dhe, më në fund, lajmëron për kryengritjen e një pashe turk në Greqi, i cili kërcënon se do të pushtojë Shqipërinë.

**40 - 1637 shkurt 8** – Letër e Frang Bardhit drejtuar Kongregacionit të Pr. F. në lidhje me disa çështje dioqezane. Ndër të tjera lajmëron se ka përkthyer në gjuhën shqipe Dëshminë e Besimit dhe Rendin Sinodal.

**1637 mars 7** – Letër e peshkopit të Lezhës, Benedikt Orsini, drejtuar një prelati në Romë. Mbrohet kundër pretendimeve të kryepeshkopit të Tivarit në lidhje me kishën e Barbullushit (REL. II/19).

**1637 prill 20** – Letër e kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, drejtuar Kongregacionit të Pr. F. në të cilën trajton çështje të veta dhe gjendjen në Zadrimë. Paraqet gjendjen e vet të vështirë ekonomike në selinë e tanishme të Tivarit dhe kërkon të zgjidhet çështja e kishës së Barbullushit (REL. II/20).

**1637 maj 5** – Letër e peshkopit të Zadrimës, Frang Bardhi, drejtuar një prelati në Romë. Porosit Dom Pjetër Samuelin. Trajton ndër të tjera çështjen e disa vendeve në kolegji për bashkëvendësat e vet dhe gjendjen e tij të vështirë ekonomike (REL. II/21).

**41 - 1637 maj 9** – Letër e Frang Bardhit drejtuar Komisarit Apostolik. Nuk pranon ta takojë në Blinisht, por, nëse dëshiron të bisedojë, të vijë ai pranë tij.

**42 - 1637 maj 22** – Frang Bardhi ia përsërit ftesën Komisarit Apostolik nëse ai dëshiron të bisedojë me të.

**1637 maj 28** – Letër e Frang Bardhit drejtuar imzot Ingolit. Më parë trajton çështjen e Dom Simon Mesit dhe mbledhjen që është zhvilluar në Blinisht për juridiksionin kishtar. Pastaj interesohet për Gjergj Vladanjin që të pranohet në një prej kolegjeve të Romës. Flet edhe për çështjen e misionarëve dhe për vizitën që ai vetë po përgatitet të bëjë në Dukagjin (REL. II/22).

**43 - 1637 maj 28** – Pjesë nga një relacion i gjatë i Komisarit Apostolik, Uskoviq, në lidhje me hetimet e bëra prej tij rreth pretendimeve juridiksionale të tre peshkopëve rivalë, por qartë del në këto hetime anësia e hetuesit i cili, në çdo rast, mbledh dëshmi në favor të pretendimeve të bashkatdhetarit të vet sllav, Benedikt Orsini.

**1637 maj 29** – Letër e peshkopit të Arbërisë, Mark Skura, drejtuar Kongregacionit të Pr. F. në lidhje me mbledhjen e Blinishtit dhe me veprimin e keq të arbitrazhit kryer prej Komisarit Apostolik Gjergj Uskoviq (REL. II/23).

**44 - 1637 qershor** – Pjesë nga relacioni i Frang Bardhit për vizitën e kryer prej tij në krahinën e Pukës: të dhëna për jetën politike, shoqërore e ekonomike.

**45 - 1637 korrik 2** – Benedikt Orsini, me cilësinë e administratorit të dioqezës së Shkodrës, i shënon Abacinë e Shirqit Gjergj Uskoviqit që e ka merituar për shërbimet e tij.

**46 - 1637 tetor 15** – Frang Bardhi dëshmon se popullsia e Barbullushit do për bari të vet kryepeshkopin e Tivarit, Gjergj Bardhi.

**1637 tetor 20/nëntor** – Relacion i kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, për vizitën e bërë në dioqezën e Tivarit (REL. II/25).

**47 - 1637 tetor 31** – Frang Bardhi i kërkon Kongregacionit të Pr. F. që kryepeshkopi i Tivarit, Gjergj Bardhi, të detyrohet të largohet nga Zadrima dhe të qëndrojë në dioqezën e vet.

**48 - 1637** – Mbishkrimi mbi varrin e Merkur Buas që gjendet në katedralen e Tarvizios.

**rreth 1637** – Pasqyrë e ndërtuar prej kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, në lidhje me statistikën e banorëve katolikë në Serbinë e epër dhe në të poshtmen (Kosovë) (REL. II/27).

**49 - 1638 mars 27** – Pjesë nga relacioni i misionarit fra Kerubino në lidhje me regjimin e privilegjuar të Zadrimës dhe me ekspeditën e Vuço Pashës mbi Kelmend.

**1638 maj/gusht** - Relacion i kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, për vizitën e bërë prej tij në famullitë e Shkodrës dhe të Zadrimës, po kështu edhe në kishën e Shën Kollit të Lezhës (REL. II/29).

**50 - 1638 qershor** – Pjesë nga relacioni i Frang Bardhit për vizitën që ai ka bërë në zonat malore kryengritëse ndaj turqve. Përveç gjërave të shërbimit shpirtëror, flitet këtu për gjendjen politike e shoqërore të atyre zonave dhe, më në fund, jepet relacioni për ekspeditën e fundit që ka kryer pasha i Bosnjes kundër Kelmendit.

**1638 qershor** – Letër e peshkopit të Zadrimës, Frang Bardhi, drejtuar Papës, me të cilën kërkon subsidin meqë të ardhurat e dioqezës janë të pamjaftueshme (REL. II/31).

**1638/1639** – Relacion i kryepeshkopit të Tivarit për vizitën e bërë prej tij në dioqezën e Tivarit dhe në atë të Serbisë (Kosovës) (REL. II/32).

**1638** – Relacion i misionarit Françesk Leonardis për Serbinë (Kosovën) dhe Shqipërinë (REL. II/33).

**51 - 1639 mars 17** – Përmbledhje e një letre të Frang Bardhit me të cilën trajton çështjen që të mësohet kleri vendas të shkruajë testamentet dhe që të rezervohet ndonjë vend për shqiptarët në kolegjet e Pr. F.

**52 - 1639 prill 2** – Peshkopi i Lezhës dhe administrator i Shkodrës ankohet për disa priftërinj që mbajnë famulli duke u mbështetur në forcën e qeveritarëve.

**53 - 1639 prill 2** – Po ai ankohet për pesë priftërinj që janë vendosur në dioqezën e Shkodrës “me krahun e turqve”.

**54 - 1639 maj 21** – Një letër e fra Kerubinit drejtuar, me sa duket, eprorit të vet, Bonaventura nga Palacolo, me të cilën i jep llogari për misionet në Shqipëri.

**55 - 1639 maj 27** – Andrea Bogdani i shkruan një prelati në Romë. Pas dy vjetësh që shërben në Kosovë, trajton disa çështje të shërbimit si famullitar.

**56 - 1639 korrik 7** – Benedikt Orsini dëshmon për punën e mirë të misionarëve dhe vë në dukje falsitetin e akuzave se ata janë spiunët e princave europianë.

**57 - 1639 shtator 14** – Fra Kerubini referon për burgosjen dhe për vështirësitë për t’u liruar për shkak të pangopësisë së qeveritarëve.

**58 - 1639 shtator 23** – Po ai referon gjithnjë në lidhje me burgimin e vet e të dy shokëve, pa asnjë shpresë se do të mund të lirohen.

**59 - 1639 tetor 28** – Po ai i shkruan imzot Ingolit në Romë duke e njoftuar se ai me shokët janë liruar më 6 tetor. Sidoqoftë, bën që frati i nisur prej tij të shkojë në Romë për të paraqitur nevojat e misioneve.

**60 - 1639 tetor 28** – Po ai i referon Kongregacionit të Pr. F. se, me interesimin e pleqve të Zadrimës dhe me dorëzaninë e tyre, ai dhe shokët e tij të burgut kanë qenë liruar. Referon pastaj për konfliktin që kanë zadrिमorët me beun qeveritar në lidhje me propozimin se kush do të jetë xhabia etj.



**61 - 1639 nëntor 6** – Frang Bardhi i shkruan një prelati në Romë për konfliktet e lindura ndërmjet misionarëve e turqve dhe jep hollësira për burgosjen e atyre misionarëve.

**62 - 1639 nëntor 6** – Po ai, me një letër tjetër dërguar në Romë, trajton gjithnjë çështjen e burgosjes dhe të lirimit të fretërve. Pastaj kalon e flet për kërcënimet nga ana e turqve. Ankohet për ndërhyrjet e kryepeshkopit Gjergj Bardhi etj.

**63 - 1640 para 3 shkurtit** – Misionari Jacint nga Sospelo me nëntë pika analizon veprën misionare në Shqipëri.

**64 - 1640 shkurt 3** – Përgjigjet që u jep Kongregacioni i Pr. F. nëntë kërkesave të P. J. nga Sospelo në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e misioneve në Shqipëri.

**65 - 1640 prill 12** – Misionari fr. Karlo dela Mirandola shkruan nga Kurbini. Flet për burgosjen e pësuar, flet mirë për veprën e peshkopit Mark Skura, kërkon disa gramatika për mësimin e djemve etj.

**66 - 1640 prill 27** – Frang Bardhi, duke i shkruar një prelati në Romë, flet për mënyrën me të cilën, duke pësuar shpenzime e mundime, populli i Zadrimeës është i detyruar që, herë pas here, të dërgojë në Kostantinopol përfaqësues për të nxjerrë nga Porta ferpane për të penguar padrejtësitë e zotërve të rrethit. Flet pastaj për punët e veta dhe për mosmarrëveshjet që ka në mes të klerit.

**67 - 1640 para qershorit** – Relacion anonim, por shihet qartë se është shkruar nga dora e sekretarit që shkruan letra të tjera të firmosura prej Benedikt Orsinit me dorë të vet, ku jepet lista e disa pikave të akuzave me të cilat rëndohet Frang Bardhi.

**68 - 1640 qershor** – Një grup priftërinjsh dëshmon në favor të Frang Bardhit kundër akuzave që i drejtohen.

**69 - 1640 korrik 11** – Letër e Gjergj Bardhit drejtuar një prelati në Romë. Gjatë kthimit prej vizitës së bërë në Romë, duke u gjendur në Raguzë, i kujton kërkesat e veta dhe e porosit të interesohet.

**70 - 1640 korrik 26** - Letër e Frang Bardhit drejtuar një prelati në Romë. Trajton çështje të misioneve në Shqipëri. Kalon pastaj dhe flet se si zadrimorët nxjerrin ferpane në Kostantinopol kundër padrejtësive të zotërve të rrethit. Më në fund kritikon qëndrimin mospërfillës të fuqive europiane.

**71 - 1640 shtator 23** – Letër e Frang Bardhit drejtuar një prelati në Romë. Mbrohet kundër akuzave që i bëhen nga armiqtë e tij. Veçanërisht ankohet për veprimet e abatit Nikollë Leka që është shkaku kryesor i shqetësimeve e konflikteve ekzistuese në Zadrimeë e gjetkë.

**72 - 1640 tetor 10** – Letër e Frang Bardhit drejtuar Kongregacionit të Pr. F. Ankohet për sjelljen e padurueshme të Gjergj Bardhit i cili, ndër të tjera, ka qenë shkaku për skandalin në kishë në prani të besimtarëve dhe jobesimtarëve. Ndjekësit e ungjit-rival dhe armik e përndjekin, e kërcënojnë për vdekje dhe e akuzojnë të gjykatores e turqve që e dënojnë me gjoka të rënda etj. Kërkon një mjet shërimi të fortë.

**73 - 1640 tetor 19** – Benedikt Orsini tregon si është zhvilluar grindja skandaloze ndërmjet Frang e Gjergj Bardhit në Zadrimeë.

**74 - 1640 nëntor** – Mark Skura, duke u gjetur në Raguzë, flet për sinodin e afërt shqiptar.

**75 - 1640 nëntor** – Copa të një letre të Frang Bardhit drejtuar një prelati në Romë. Parashtron rastet e përndjekjeve që i shkaktojnë armiqtë e tij.

**76 - rreth 1640** – Në një letër drejtuar një prelati në Romë, Mark Skura bën një paraqitje të çrregullimeve që konstatohen në jetën e fretërve.

**77 - rreth 1640** – Kryedhaku Françesk de Leonardis, në atmosferën e përpjekjeve për bashkimin e kishave, jep një paraqitje për jetën shembullore të mbretit Urosh, që ortodoksët e quajnë shenjt dhe që mundësisht të shpallet i tillë edhe nga ana katolike.

**78 - 1641, para 29 janarit** – Letër e Frang Bardhit me të cilën i referon Kongregacionit të Pr. F. për sjelljen e keqe të misionarëve si pasojë e së cilës ka qenë nevoja të paguheshin shuma të mëdha për të nxjerrë lirin e tyre nga burgu. Flet për shpenzimet që nevojiten për të nxjerrë nga Porta fermanet e nevojshme që t'u vihet fre padrejtësive të zotërve të rrethit, flet për taksën e re mbi verën etj.

**1641 prill 19** – Relacion i peshkopit të Zadrimës, Frang Bardhi, paraqitur Papës në lidhje me gjendjen në Zadrimë (REL. II/34).

**79 - 1641 prill 19** – Pjesë nga relacioni i Frang Bardhit mbi Zadrimën dhe mbi vise të tjera të lidhura me të.

**80 - 1641 maj 29** – Pjesë nga një letër e Gjergj Bardhit drejtuar Kongregacionit të Pr. F. në të cilën ankohet për nipin e vet Frangun i cili nuk i mban premtimet që i ka bërë për ta ndihmuar.

**81 - 1641 korrik 9** – Po ai i shkruan një kardinali në Romë në lidhje me koncilin që duhet mbajtur në Shqipëri.

**82 - 1641, para 22 gushtit** – Frang Bardhi, me dorën e vet, dërgon kopjen e akuzave me të cilat rëndohet Nikollë Leka për keqbërjet e tij, ndër të cilat edhe nyja 12 që e fajëson për vdekjen e Pjetër Budit.

**83 - 1641, rreth 22 gushtit** – Një memorial i Frang Bardhit në nëntë pika, me të cilin, përveçse sqarohet përse është i nevojshëm largimi i Gjergj Bardhit nga Zadrima, flitet edhe për masa të tjera që duhen marrë për të ndrequr të pabindurit etj.

**84 - 1641 gusht 22** – Frang Bardhi, i kthyer në Zadrimë nga udhëtimi i tij në Romë, referon për çrregullimet e shkaktuara në mungesë të tij nga Gjergj Bardhi dhe Nikollë Leka. Flet pastaj për bakshishin që i është dashur t'i jepte sanxhakbeut etj.

**85 - 1641 gusht 29** – Benedikt Orsini i shkruan një prelati në Romë për hetimin që po përgatitet në lidhje me veprimtarinë e Nikollë Lekës dhe për atë që e quan njeri me hënë, Frang Bardhin.

**86 - 1641 shtator 28** – Benedikt Orsini referon për grindjet që ekzitojnë ndërmjet peshkopit të Zadrimës, Frang Bardhi, dhe abatit, Nikollë Leka.

**87 - 1641 tetor 22** - Prifti Gjergj Jubani referon për misionin e Grudës, etj.

**1641 dhjetor 20** – Relacion i Mark Skurës drejtuar Kongregacionit të Pr. F. për vizitën që ka bërë në dioqezat e Shqipërisë Qendrore (REL. II/36).

**1641/1642** – Relacion i Gjergj Bardhit për vizitën e bërë në Kosovë dhe vende të tjera përreth (REL. II/37).

**88 - 1642 mars 25** – Prifti Gjergj Jubani referon për grindjet në Zadrimë.

**89 - 1642, para 17 prillit** – Procesverbali për zhvillimin e gjyqit në Kallmet në lidhje me akuzat kundër abatit Nikollë Leka.

**90 - 1642 prill 17** – Në një përmbledhje që i është bërë letrës së Frang Bardhit del protesta që ai ka bërë në lidhje me zhvillimin e gjyqit mbi veprimtarinë e abatit Nikollë Leka.

**91 - 1642 prill 29** – Prifti Gjergj Jubani referon për ecurinë e mbarë të misionëve.

**92 - 1642 qershor 9(?)** – Prifti Simon Mesi flet për dëmet që ka pësuar familja e vet dhe kërkon ndihmë.

**93 - 1642 korrik 12** – Frang Bardhi, duke i shkruar një prelati në Romë, flet për përndjekjet që pëson nga ana e ungjit të vet, kryepeshkopit të Tivarit, me përkrahjen e abatit Nikollë Leka. I ka ardhur shpirti për të dalë dhe thotë se është i gatshëm të largohet, por më parë kërkon të bëhet drejtësi.

**94 - 1642 korrik 23** - Kryepeshkopi i Tivarit, Gjergj Bardhi, ankohet për priftin e Shkupit i cili ka vënë peng plaçkat e kishës.

**95 - 1642 korrik 23** – Gjergj Bardhi informon një prelat në Romë për vizitën e bërë në Kosovë dhe për shpërdorimet e priftit të Shkupit.

**96 - rreth 1642** – Relacion, duket nga dora e Benedikt Orsinit, në lidhje me regjimin me të cilin qeveriset Zadrimea.

**1643 janar 12** – Letër e kryepeshkopit të Durrësit, Mark Skura, drejtuar imzot Ingolit, me të cilën kërkon subsidin etj. (REL. II/38).

**1643 shkurt 2** – Letër e po atij drejtuar një prelati në Romë, me të cilën kërkon që t'i caktohet një peshkop ndihmës dhe propozon fra Simon Sumën (REL. II/39).

**1643 shkurt 2** – Po ai i shkruan imzot Ingolit për vështirësitë që i dalin në administrimin e dioqezës dhe pohon nevojën që të emërohet një peshkop i Kanovisë, propozon Simon Sumën (REL. II/40).

**1643 shkurt 4** – Po ai i shkruan Kongregacionit të Pr. F. për të njejtën çështje (REL. II/41).

**1643 qershor 10** – Po ai i shkruan një prelati në Romë për subsidin e vet dhe për nevojën që të emërohet një peshkop për Kanovinë (REL. II/42).

**1643 gusht 15** – Urdhëresë e kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Bardhi, me të cilën shpall interdiktin për kishën e Shën Mërisë së Dejës sepse nuk e lejojnë që të meshojë aty dhe i mohohen të drejtat peshkopore (REL. II/43).

**97 - 1643 gusht 29** – Gjergj Bardhi, duke i shkruar një prelati në Romë, ndër të tjera, kërkon që të caktohet për të drejtuar dioqezën e Zadrimës pasi ka vdekur Frang Bardhi.

**98 - 1643 shtator 1** – Po ai, duke marrë administrimin e Zadrimës, lëshon një urdhëresë që secili të paguajë atë që i përket peshkopit.

**1643 shtator 15** – Po ai i shkruan imzot Ingolit që të përpiqet t'i caktohet selia e Zadrimës pasi ka vdekur titullari (REL. II/46).

**1643 tetor 16** – Letër e kryepeshkopit të Durrësit, Mark Skura, drejtuar imzot Ingolit. Lajmëron se turqit kërcënojnë se do ta shndërrojnë katedralen e Durrësit në fortesë, prandaj kërkon të holla për të shmangur këtë rrezik. Çek gjithnjë çështjen e emërimit të Simon Sumës (REL. II/47).

**99 - 1643 tetor 16** - Kleri dhe pleqtë e Zadrimës i drejtohen Papës dhe Kongregacionit të Pr. F. që Gjergj Bardhi të kthehet për të drejtuar dioqezën.

**1643 tetor 25** – Letër e Gjergj Bardhit drejtuar imzot Ingolit me të cilën trajton çështjen e emërimit të vet peshkop në Zadrinë dhe çështjen e dy priftërinjë që janë larguar nga famullitë përkatëse (REL. II/48).

**1643 nëntor 16** – Letër e kryepeshkopit të Durrësit, Mark Skura, drejtuar Papës, me të cilën kërkon autorizimin që të shpëtojë meshtar një frat ndihmës (REL. II/49).

- Ish mbreti, historiku i dinastisë – 77.

**Uskoviqi, Gjergj**

- 1637, komisar apostolik për juridiksionet dioqezane, pastaj abat i Shirqit – 37, 41, 42, 43, 45.

**Vaglevo**

- Qytet në Serbi – 153 (fl. 2).

**Valdibono ose Valebona**

- sh. *Kerubino*, fra.

**Valenshtajni**

- 1627, rekruton ushtarë – 14.

**Vangjelista (fra) nga Venediku**

- 1639, misionar i burgosur – 57, 58, 65.

**Vangjelisti nga Raguza**

- 1634, frat – 22.

**Vasiljeviqi, d. Juani i Marinit**

- 1642, prift në Shkup – 94, 95.

**Vatrat e Qëndresës**

- Zonat e lira malore : Mbishkodër, Lezhë, Krujë- 27 (fl. 16rv), 34 (fl. 44v), 35, 50, 119.

**Vau i Dejës**

- Qyteti i rrënuar – 79 .

**Velja**

- Mali i Lezhës – 114.

**Vendramin, Andrea**

- 1633, proveditor i Kotorrit – 20.

**Venzio, d. Johan**

- Në Romë – 83.

**Verioni (Vrioni), fra Pjetri**

- 1652, françeskan – 160.

**Verona**

- Në mbishkrimin e M. Buas – 48.

**Vezuvi**

- 1631, shpërthimi dhe shiu prej hiri në bregun lindor të Adriatikut – 19.

**Vicentini, Athanas**

- 1635, i shënuar misionar në Shqipëri – 25 (fl. 23), 27 (fl. 17).

**Vigu**

- Kufi Zadrimë-Lezhë- 43 (fl. 157r).

**Vladanji, Gjergj**

- 1647, u shkruan shqiptarëve të mos u besojnë venedikasve – 105.

- 1651, propozohet për peshkop të Lezhës – 137.

**Vladimiri**

- I dyti mbret sllav me këtë emër – 77 (fl. 305rv).

**Vlashanji**

- Zonë e lirë e Mirditës – 21, 35.

**Vlora**

- Tregu, konsuj – 13, 17.
- 1631, shiu prej hiri nga Vezuvi – 19.
- 1637, kryengritja e një pashai – 39.
- 1640, kthehen nga Italia disa familje arbëreshe – 70 (fl. 444).

**Vojvoda**

- 1635, kërcënon misionarët – 24, 25, **27** (fl. 14), 34.

**Vojvoda i Spasit**

- 1640, kërcënon Frang Bardhin – 66.

**Vrioni**

- sh. *Verioni*.

**Vuçiterni**

- Vend që shkon me Prizren – 143.

**Vuço pasha**

- Ekspedita mbi Kelmend – **49, 50**.

**Xhabia**

- I dërguar i Sulltanit në Zadrimë për të mbledhur detyrimet – 54 (fl. 389rv), **60, 79, 96**.

**Zadrима ose Sapa**

- Zona e privilegjuar, vendi, banorët, jetesa, prodhimet etj. – 21, 24, 27 (fl. 13), **44, 78** (fl. 204), **79, 96**, 124.
- Zonat e lira malore – 18, 21, 35, 79.
- Raportet me sundimtarët, dhunat, xhabia dhe detyrimet etj. – **49**, 54 (fl. 389), **60**, 62 (fl. 448v), 66, 70, 72 (fl. 208v), **78, 79**, 96, 169 (fl. 203).
- Dioqeza, juridiksioni etj- 27 (fl. 15v, 18), 30, 31, 34 (fl. 43Av), **37**, 38, 41, 43 (fl. 152, 153, 155, 156, 157), 44, 52, 61, 62, 66, 67, 71 (fl. 206v), **72, 73, 79**, 87, 88, 97, **98**, 99, 117, 124-126, 151, 169 (fl. 201).
- Misioni, misionarët – 25 (fl. 23), 57, **60, 61, 62**, 63 (nr. 6).

**Zara (Zadar)**

- Në Dalmati, 1646, kërcënimi osman – 103.

**Zejmeni**

- Në J të Lezhës – 33, 43 (fl. 152rv).

**Zi (i), dom Jaku**

- 1637, famullitar i Kallmetit – 43 (fl. 152v, 153rv, 155r, 156rv).

**Zi (i), dom Nikolla**

- 1643, prift në Zadrimë – 99.

**Zi (i), dom Pjetri**

- 43 (fl. 154r, 156r).

**Ziu**

- sh. *Neri*.

**Zoganji (Zogaj)**

- Në rrethe të Prizrenit – 169 (fl. 198).

**Zojmeni**

- sh. *Zejmeni*.

**Zubçi**

- Në rrethe të Tivarit – 121.

**Zhabjaku**

- Në skajin verior të liqenit të Shkodrës – 115.

---



## BURIMI ARKIVAL DHE BIBLIOGRAFIA

**BURIMI ARKIVAL** – Janë transkriptuar nga fotokopjet dhe botohen për herë të parë këto dokumente:

**Arkivi i Propaganda Fide, Romë** – me siglën: **A.Pr.F.**, nga fondi: S.O.C.G. (Scritture Originali Congregazione Generale).

Vëllimi 60: Dok. Nr. 87, 88, 90-95.

Vëllimi 124: Dok. Nr. 51-66, 69, 70, 74, 76.

Vëllimi 125: Dok. Nr. 68, 71-73, 75, 78, 80, 81, 83-86.

Vëllimi 127: Dok. Nr. 97-99, 101.

Vëllimi 220: Dok. Nr. 117, 118, 133, 139, 141-144, 153-156, 163, 165, 167.

Vëllimi 263: Dok. Nr. 22, 24-38, 41-43.

Vëllimi 264: Dok. Nr. 67, 77, 82, 89, 96.

Vëllimi 265: Dok. Nr. 120-132, 134-138, 140, 145-152, 162.

Vëllimi 266: Dok. Nr. 158-161, 164, 166, 169.

## BIBLIOGRAFIA

**BRUSONI**, Hist. Ult. Guer. – Historia dell'ultima Guerra tra' Veneziani e Turchi etc. (Candia e Dalmazia) dall'anno 1644 fino al 1671; Venezia, Stefano Curti, 1673.

**CATUALDI**, S.J. (O. De Hassek) – Sultan Jahja dell'imperial casa ottomana od altrimenti Alessandro Conte di Montenegro etc. Nuovi contributi alla storia della Questione Orientale etc. Pubblicati da Vittorio Catualdi etc., Trieste, G. Chiopris, 1889.

**DUJCEV**, Avv. Rag. – Dr. Jvan Dujcev, Avvisi di Ragusa, Documenti sull'Impero Turco nel sec. XVII e sulla guerra di Candia. Pont. Institutum Orientalium Studiorum, Roma, 1935.

**FARLATI-COLETI**, Ill. Sac. VII. Illyrici Sacri Tomus Septimus Ecclesia Diocletiana Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis cum earum Suffraganeis Auctore Daniele Farlato etc. Et Jacobo Coletto etc., Venetiis, MDCCCXVII apud Sebastianum Coleti etc.

**FERMENDZIN**, Acta Bosnae – Acta Bosnae porissimum ecclesiastica cum insertis editorum documentorum registis ab anno 925 usque ad annum 1752. Collegit et digessit P. Eusebius Fermendzin etc.; në: MONUMENTA etc. Slavorum Meridionalium etc. V. XXII, Zagrabiae 1892.

**GRANATA** – Rivista Alb.- L'Albania e le Missioni italiane nella prima metà del secolo XVII in base a documenti inediti, di Fernanda Granata; në: RIVISTA d'Albania, Anno III, fasc. IV, 1942, dicembre.

**LAMANSKY**, S.E.V. – Secrets d'Etat de Venise, Documents, extraits, notices et études etc. Par Vladimir Lamansky, etc., Saint-Pétersbourg, 1884.

**LEVI**, Ven. Cor. Lev. – Venezia, Corfù ed il Levante, Relazione storico-archivistica di Cesare Augusto-Levi; vol. I Testo. Venezia MCMVII, off. Graf. C. Ferrari.

**MAKUSHEV-SUFFLAY**, Starine XXXI – Isprave za odnosaj Dubrovnika prema Venecij; Sabrao Prof. Vikentij Vasiljevic Makusev, za tisak priredio Dr. Milan Sufflay, në STARINE etc., kn. XXXI, Zagreb 1905.

**PARIBENI** – Paribeni R. Venti anni etc., në RIVISTA d'Albania, 1940, I/31.

**PREMROU**, Ark. Arb. Star. – Sitniji prillozi Pepel iz l. 1631, në ARKIV za Arbanska Stariny, kn. II, sv. 1, Beograd 1924.

**RELACIONE** – Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të mesme në shek. XVII, teksti origjinal dhe përkthimi përgatitur nga Injac Zamputi, vëllimi I (1610-1634), Tiranë 1963; vëllimi II (1634-1650), Tiranë 1965.

---

## Jetëshkrim i Injac Zamputtit<sup>570</sup>

Lindi në Shkodër më 12.02.1910 në një familje të mesme. I jati, Romolo, me origjinë italiane, zyrtar poste, vdes shpejt pas një aksidenti duke e lënë jetim në moshën njëvjeçare së bashku me tri motra. E ëma, Nine, me origjinë nga malësia, nga Temali, i rrit këta fëmijë me mundime e sakrifica.

Studjon në Kolegjin Saverian të Jezuitëve në Shkodër ku shquhet për korrektësi dhe rezultate shumë të mira. Prandaj, qysh në moshën 21 vjeçare mbahet në atë Kolegj ku jep lëndën e letërsisë shqipe si koleg i ri i Dom Ndre Mjedës. Merr pjesë në mjaft shfaqje teatrore, në fillim si nxënës e më vonë si drejtues. Po kështu merr pjesë në shfaqje muzikore duke i rënë violinës e mandolinës si amator. Jep ndihmesë të madhe në revistën "Leka" si bashkëpunëtor i A. Zef Valentinit. Si mësues i ri dallohet në aktivitetet kulturore, artistike e sportive me nxënësit.

Ndër nxënësit e tij mund të përmendim: V.Stafën, L.Boriçin, Q.Stafën, S.Bekteshin etj. (Duhet shënuar se në atë Kolegj studionin edhe nxënës të besimeve të tjera). Më 1937 martohet me një vajzë shkodrane, Rozën, nga familja e Prelajve dhe patën 6 fëmijë: 5 vajza e 1 djalë. Ndërkohë mbaron universitetin me korrespondencë në Trieste ku doktorohet në shkenca politike e mbron temën historike: "700-a Veneciane dhe Shqipëria Turke", pa e ditur se e ardhmja e jetës së tij do të ishte pikërisht historia e mesjetës e Shqipërisë. Pas mjaft shkrimeve, artikujve, poezive, përkthimeve etj. në shtypin e kohës me pseudonime të ndryshme, më 1940 boton vëllimin e parë me novela "Zemra njerzish" e më 1944 vëllimin e dytë me novela "Atje, nën hijen e Rozafës" dhe melodramin "Damjani himarjot". Në vitet e fundit në Kolegjin Saverian, së bashku e nën drejtimin e A. Z. Valentinit, hedhin bazat e albanologjisë shqiptare e kjo do t'i shërbejë si bazë e mirë për studimet e mëvonshme historike të tij.

Pas luftës, më 1945, punon si drejtues i Shtëpisë së Kulturës në Shkodër e më pas, 1946-48, dërgohet në Gjirokastrë si mësues letërsie në liceun e atij qyteti. Me hapjen e Institutit të Shkencave thirret në Tiranë ku i caktohet sektori i historisë së mesjetës. Në vitin 1949 (sipas gazetës "Panorama" të 30 nëntorit 2009 mbi dosjen e E. Çabejt dhe sipas kujtimeve të lëna nga vetë Injaci) fillon një presion i madh mbi të për t'u rekrutuar nga Sigurimi i Shtetit, por ai refuzon në mënyrë kategorike. Për këtë refuzim nuk foli me askënd gjithë jetën dhe pasojat e këtij refuzimi e ndoqën gjithnjë atë dhe familjen e tij.

Qëndron, deri më 1953, i vetëm në Tiranë, ku, më në fund, i jepet shtëpi vetëm me një dhomë, paradhomë e guzhinë për familjen me 10 vetë (nëna, motra, grua-ja e 6 fëmijët), me tri familje të tjera në një korridor e një banjo të përbashkët. Aty punoi e jetoi për 40 vjet e aty i shkroi veprat e tij herë në stol, herë në tavolinën e vogël e herë në prehër, duke u kërrusur gjithnjë e më shumë mbi dokumentat e historisë pa kërkuar asgjë e pa i trokitur në derë askujt. I hyri punës me pasion,

---

<sup>570</sup> Vetëm gjatë periudhës së diktaturës e ka shkruar mbiemrin me një t: ZAMPUTI, por deri më 1944 e në të gjithë regjistrat e gjendjes civile, edhe të periudhës së diktaturës, mbiemri shkruhet me dy t: ZAMPUTTI.

sepse kështu gjeti mënyrën për të shprehur intelektin e bagazhin e tij, për të mbajtur familjen e për të mbijetuar.

Ndër punimet e para është zbërthimi i alfabetit të dorëshkrimit të quajtur "Anonimi i Elbasanit", transkriptimi e komentimi i tij, duke e çuar së paku në shek. XVII lëvizjen e ritit ortodoks për një liturgji në gjuhën shqipe. Po kështu zërthen alfabetin e panjohur të shek. XIX të një poezie me përmbajtje bektashiane.

Më pas boton librin "Përpyekjet e shqiptarëve për liri e pavarësi në shek. XVI-XVII". Fillon të përgatisë kuadrin e ri për dokumentacionin e periudhës së mesjetës, u jep drejtime se ku të shkojnë për ta kerkuar në arkivat e ndryshme të Venecias, Vatikanit, Raguzës etj. Ia sjellin këto dokumenta me mikrofilma e ai, nga fotokopjet, duke përdorur shpesh thjerrrëzën, i transkripton, i përkthen, i komenton e kështu boton 10 vëllime në kuadrin e Institutit të Historisë me relacione, regjistra, shënime të ndryshme të asaj kohe. Ai vetë nuk u lejua asnjëherë të dilte nga Shqipëria për gjetjen e dokumentacionit ose për të marrë pjesë në kongrese, konferenca apo simpoziume të ndryshme ku ftohej nga të huajt. Shkolla që kishte kryer, kultura që kishte marrë nga Jezuitët, kontaktet që kishte pasur para lufte e bënin person të dyshueshëm që duhej mbajtur nën mbikqyrje nga regjimi.

Kështu, me punën e tij të palodhshme, u mbush ai boshllëk i madh që ekzistonte në periudhën e historisë së Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut, duke nxjerrë ne pah organizimin e maleve për luftën kundër otomaneve, kuvendet shqiptare, kontaktet me Europën etj. Konkluzionet e studimeve të dokumentacionit botoheshin në formë artikujsh në "Buletini për Shkencat Shoqërore" e më pas "Studime historike". Nga dokumentacioni i kohës zbulon e studjon mjaft hollësi të shkrimtarëve të vjetër shqiptarë Buzuku, Bardhi, Budi, Bogdani e të humanistëve shqiptarë Barleti e Beçikemi.

Të periudhës 1960-1990 janë vëllimet:

RELACIONE mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII

Vëllimi I (1610-1634), Tiranë 1963, fq. 1-538

Vëllimi II (1634-1650), Tiranë 1965, fq. 1-525

DOKUMENTA të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë

- pjesa e parë (1479-1499), Tiranë 1967, fq. 1-309

- pjesa e dytë (1499-1506), Tiranë 1979, fq. 1-559

REGJISTRI i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417, Tiranë 1977, fq. 1-499

DOKUMENTE të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë

- vëllimi i parë (1507-1592), Tiranë 1989, fq. 1-490

- vëllimi i dytë (1593-1602), Tiranë 1990, fq. 1-387

- vëllimi i tretë (1603-1621), Tiranë 1989, fq. 1-465

- vëllimi i katërt (1675-1699), bashkëautor me Selami Pulahën, Tiranë 1990, fq. 1-569

DOKUMENTE për Historinë e Shqipërisë të shek. XV, bashkëautor me Luan Malltezin, vëllimi i parë (1400-1405), Tiranë 1987, fq. 1-712

Të gjitha këto vëllime janë botuar me transkriptimet origjinale, përkthimet përkatëse, me indeksat e emrave të personave e të vendeve dhe me shpjegimet e duhura. Vetëm në këto vëllime dokumentash numërohen më shumë se 5000 faqe.

Në vitet '50 e fillimet e viteve '60 merret edhe me letërsi e përkthime. Shkruan tri drama, një melodramë, dy tregime të gjata, një poemë për luftën e Himarës 1481, por nuk lejohen të botohen. Në vitet '50 përkthen operan "La Bohème" që vihet në skenë, por më pas venë dorë të tjerët, me pretekstin e dialektit verior të përdorur, në mënyrë që të mos dilte më emri i tij. Po kështu përkthen komedinë e Goldonit "La Locandiera" (Zoja e bujtinës) që ka të njejtin fat si opera. Kështu, heq dorë nga letërsia e përkthimet dhe i kushtohet krejtësisht historisë e paleografisë. E vetmja dramë që arriti të dëgjohet vetëm një herë në radio e inçizuar nga studentët e degës së dramës të ILA më 1965 qe drama "Guri i themelit" me temë mbi Kalanë e Rozafatit.

Vijnë vitet e zeza 1967-68 - revolucioni kulturor - e ai është në shenjestër për ideologjinë e tij fetare e për të kaluarën e tij duke u sulmuar me fletë-rrufe e me mbledhje të pafund. Por ai e përballon edhe këtë sulm e gjithnjë me pasion, më shumë i mbyllur në shtëpi, vazhdon e punon duke jetuar me botën e Budit, Bogdanit, Bardhit etj. (Për të kuptuar më mirë këtë sulm dhe si e përballoi, rekomandojmë kumtesën "Historia evropiane e Injac Zamputti" botuar në gazetën "Shekulli", Nr. 2878, 14 shkurt 2010, fq. 16-17, mbajtur nga Pëllumb Xhufi në përkujtimin e 100-vjetorit të lindjes së autorit).

Asnjëherë nuk ia njohën titullin doktor e laurën e Triestes, megjithëse pothuajse të gjithë e thërrisnin: "Profesor". Nëse deri në vitin 1967 boton në organet e ndryshme (me përjashtim të "Zërit të Popullit") shkrime mbi rezistencën e popullit shqiptar mbas vdekjes së Skënderbeut, mbi shkrimtarët e vjetër etj., mbas këtij viti e deri në vitin 1987 nuk lejohet më të botojë nëpër organe të ndryshme, përveç "Buletinit" e "Studime Historike".

Të vitit 1984 janë punimet e tij me shumë interes për leximin e "Mbishkrimit të Arbërit" e "Mbishkrimit të Brarit" të cilët lexohen për herë të parë në mënyrë të plotë dhe që vendosin gurë themeli në historinë e popullit shqiptar.

Në fundin e viteve '80 e ndjen se do të ndodhnin ndryshime të medha. Përkthen më 1989 "Burgimet e mija" të P. Vasës duke e pajisur me parathënie e shënime të ndryshme. Ftohet po atë vit edhe në një emision televiziv kushtuar figurës së atij rilindasi. Të periudhës së viteve të para të demokracisë janë dy librat e tij: "Fishta - koha, njeriu, vepra" dhe "Ekskursion në dy vepra të Kadaresë" (1993). Në vitet 1995-97 boton artikuj e studime me shumë interes në revistën "Hylli i Dritës" për çështje të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe, për aksionin kolonizues të Dionisit e luftrat iliro-romake, etj.

Më 1995 nga Presidenti i Republikës i jepet dekorata "Punonjës i shquar i shkencës dhe i teknikës" me motivacionin "Për kontribut shumë të shquar në zhvillimin e shkencave albanologjike".

Mbylli sytë më 28. 02. 1998 në Tivoli të Italisë dhe, sipas porosisë së tij të fundit, eshtrat e tij prehen në varrin e familjes në Tiranë, në Shqipëri, në atë vend, historisë së të cilit i kushtoi jetën dhe veprimtarinë e tij.

**Jozef Zamputti**

**I – Botimet e mija të viteve tridhetë deri me 1944**

Në vitet tridhetë deri me 1943, me pak përjashtime, kam qenë mësues Gjuhe dhe Letërsije në gjimnaz-liceun të Kolegjës Saveriane të Shkodrës që drejtohej prej Jezuitëve dhe në Seminarin Papnuer ku dhania e mësimit bahej e përbashkët.

Kam qenë ndihmës i Atë Zef Valentinit për të përkohëshmen LEKA dhe për Albanologjinë Saveriane deri sa nënshkrova, me cilësinë e Sekretarit, Diplomat për anëtarët e Akademisë Saveriane.

Gjatë kësaj kohe kam botue novela, poezi, studime gjuhësore, vizatime për ngjarje shoqërore të ndryshme, portrete personazhesh, recensione, kritikë letrare dhe përkthime. Kam botue një melodramë në LEKA, pastaj dy libra me novela dhe librin e përkthyer të Shenjtes Terezinë të Krishtit Fëmijë.

Ishte zakoni aso kohe që botimet e rinisë të dilnin me pseudonim. Unë kam përdorë rreth 12 të tillë. Ka pasë edhe shkrime të mija që nuk kishin asnjë pseudonim.

Pseudonimi kryesor që kam përdorë në të përkohëshmen LEKA ka qenë ALES, por edhe ndonjë tjetër. Pseudonimin e ALES e kam përdorë edhe në të përkohëshme të tjera. Kritikën letrare i kam botue pa pseudonim. Shumë vonë dola me emnin tim të plotë.

Ruej kopjet e shkrimeve të mija të botueme, por ndonjeha edhe më ka humbur. Aso kohe nuk e dija vlerën e bibliografisë personale dhe shumica e kopjeve që ruej nuk e kanë vitin as muejin e botimit, prandaj ndonjë mund të mos jetë i saktë.

I kam klasifikue shkrimet e mija, të botueme deri me 1944, në këtë mënyrë:

**1 – Botime me karakter letrar**

*Ndër libra e fletore*, Leka, 1935.

*Damiani Himariot, novelë*, Leka, 1936.

*Damiani Himariot, melodramë*, Leka, numër përkujtimor i vitit 1937 – libër më vete 1943.

*Nji parë dorca*, Cirka, prill-maj 1937.

*Zemra njerzish*, libër me novela – Shkodër Shtyp. “Zoja e Paperlyeme”, 1940.

*Atje nën hijen e Rozafës*, libër me tregime – Ismal Mal’Osmani, Botonjës, Tiranë 1944.

**2 – Botime me karakter gjuhësor**

*Ku kjeme e ku po shkojmë*, Zot. Dr. D. K., Cirka, prill 1938.

*Gjithkush atë të veten*, Cirka, 5 korrik 1938.

*Aoristi shqip*, Leka, kallnduer 1943.

---

<sup>571</sup> Po e sjellim bibliografinë siç e ka renditur vetë autori në vitet 1994-95 duke shtuar botimet pas këtyre viteve – J.Z.

*Po-hi dhe Jo-hi ndër bisedat tona*, Kumbona e së Dieles, 1943.  
*Germa A ndër përgjegjet-pëvetëse*, Kumbona e së Dieles, 1943.  
*Prap mbi Falemi Rregjineshën*, Zani i Shna Ndout, Shtatuer 1943.  
*Emëni dhe mbiemëni (llagapi)*, Shkëndija, 1943.

### 3 – Vizatime me karakter shoqnor

*Magazinë puthjesh*, Gazeta Tomori, 1940.  
*Kapela burrash për gra*, “ “ “  
*Tri episode ndër karroca*, “ “ 1941.  
*Nana ka qitë në zjerm djepin tim*, “ “ “

### 4 – Recensione dhe kritikë letrare-artistike

*Bylbyli i Shkodrës*, Leka, 1936.  
*Recension për Fjalorin italisht-shqip të Atë Fulv Kordinjanos S.J.*, Leka, kalInduer-fruer 1939.  
*Tue rrahun fletët mbi “Bagëti e Bujqësija” të Naimit*, Tomori, 1941.  
*Atë Gjergj Fishta – gjeni shqiptare, gjeni botnore*, Numri unik për Fishtë, i përkujdesun prej Atë Benedikt Demës OFM, Tiranë “Distapur”, 1943, fq. 533.  
*Kur flasim për të Mëdhaj*, Leka, fruer 1943.  
*Kur flasim për të Mëdhaj – replikë*, Leka, prill-maj 1943.  
*Zef Skiroj këndon vdekjen e të Birit*, Tomori i Vogël, 1942.  
*Gjon Kolë Kujxhija, “Valle Kombëtare”, vëll. I “Dasëm Shkodrane” (Il Cenacolo, Firenze)*, Leka, shtatuer- tetuer 1943.  
*A. Gjergj Fishta OFM, “Mrizi i Zanave”, komentuem prej A. Viktor Volaj OFM*, Kumbona e së Dieles, 1941.  
*Izedin Jashar Kutrulija dhe Mitrush Kuteli, “Sulm e lot”, Hylli i Dritës*, korrik 1944  
*Arshi Pipa, “Lundërtarët”, Hylli i Dritës*, korrik 1944.

### 5 - Portrete

*Nji pergamenë*, Leka, 1936-37.  
*Zi në familje te “Lekës”, Leka 1937.*  
*Në kujtim të Fr. Natale Zanonit S.J.*, Lajmtari i Zemrës së Krishtit (?)  
*Në vdekje të Fr. Pashko Shestanit S.J.*, Lajm. i Z. së Kr., 20 gusht 1944.  
*Për Zef Harapin*, Leka (?)  
*Veteran*, Leka, 1937.  
*Vdiq Padër Gjergj Fishta*, Tomori, 1941, përfshimë në numrin unik mbi Fishtë të A. B. Demës, 1943, fq. 562.  
*Fytyra e Fishtës*, Kumbona e së Dieles (?).

### 6 – Kumtesa me karakter informativ historik-shoqnor

*Nisë botimi i njëj vepre monumentale Albanologjike*, Gazeta e Shkodrës, 1940  
*Shqipnija Turke dhe Shqipnija Venedike*, Tomori, 8.IX.1942.  
*Nji kryengritje e Kelmendasve në fillim të shekullit XVIII*, Kumbona e së Dieles, 1943 (?).  
*Për historinë e gazetarisë.*

a) *Zanafillat.*

b) *Çpikja e shtypit dhe gazetarija deri me 1700*, Shkëndija, 1943.

*Danca, material e mendime për një artikull*, Leka, 21 shtator 1944.

7 – *Botime me karakter folklorik*

*Fjalë e të bame të Nastradinit*, Leka (?).

*Martesa shkodrane*, në antologjinë “Bota Shqiptare”.

*Gjamë sipas kanunit*, Kumbona e së Dieles, nanduer 1943.

8 – *Përkthime me karakter letrar*

*Pjerini i Vogël*, Lajmtari i Zemrës së Krishtit, mesi i viteve njëzet.

*Disa poezi japoneze*, Leka, nr. 8-9 (shtatuer-tetuer), 1943.

*Një nga kangët e poemës finlandeze “Kalevala”*, Leka, 1943 (?).

*Made in Japan*, Rrezja e Rrethit, 1943.

*Gjuhët e Europës*, “ “ “

*“Jakoba” e shkrimtares Grazia Deledda*, Kumbona e së Dieles, 1943.

*Requiem e Mozart-it*, “ “ “

*Anekdotat andej e këndej*, “ “ “

*Klienti nr. 13, Jean Rameau*, “ “ “

*Historija e një shpirti – autobiografija e Shenjtes Terezinë e Krishtit Fëmijë*, botim i Kumbonës të së Dieles, nr. 15, Shtypshkroja “Shqypja”, Shkodër 1944.

9 – *Poezi të rasëshme*

Kur Mjedja botoi poemën “Lirija”, botova një poemë timen në LEKA me shtatë tingllime.

Në vdekjen e Filip Shirokës, botova në LEKA një tingllim që mbushi plot një faqe të revistës.

*Dom Ndre Mjedja (poezi)*, Leka, nr. 8-9, 1938

*Anton Baldaçit (poezi)*, Leka, 1938

Kur Valentini vuni raftat shkodranë në Albanologjinë Saveriane botova në LEKA poezinë drejtue atij.

Në librin e tregimeve “Atje nën hijen e Rozafës” janë përfshimë, për variacion, disa poezi me karakter tregimtar, që do të ishin po aq tregime-novela: *Nji Valzer*, fq. 27; poezinë e përfshime në tregimin *E shituemja*, fq. 55-56; poezinë e përfshime në tregimin *Lulja e kopshtit tim*, fq. 62-63; *Rromke*, fq. 65-67; *Dallndyshës në vjeshtë*, fq. 85-86.

## II – Botimet e mija të periudhës kur kam punue në Institutin e Historisë

Në vitin 1945, për veprimtarinë time letrare, qeshë ftue dhe qeshë ndër anëtarët themelues të Lidhjes së Shkrimtarëve. Pasi qeshë për dy vjet mësues Letërsije në Liceun e Gjirokastrës (1946-1947), qeshë ftue si kuadër në Institutin e Studimeve Shqiptare, të trashiguem nga e kaluemja dhe që, në fillim të vitit 1948, ndryshoi funksion dhe emën: Instituti i Shkencave.

M’u dha detyra të organizoja Arkivin Historik me funksion të shefit teknik, funksion që e mbajta deri me 1951. Pastaj kalova në Sektorin e Historisë së



Mesjetës dhe m'u dha detyra të nisja studimet për ndërtimin e historisë politike të perjudhës së parë të pushtimit osman deri në shekullin XVIII.

Gjatë punës sime studimore dhe kërkimore, si në Arkivin Historik ashtu edhe në Bibliotekën Kombëtare, kam pasë përherë kujdes të mos lija asgjë me interes pa marrë shënim për studimet e mija. Prandaj kam botue studime edhe në fushë të gjuhësisë, letërsisë, sociologjisë, arkeologjisë, etnografisë.

Kam pasë përherë parasysh, në studimet e mija, të mbështetesh në materialet burimore primare ma fort se në bibliografinë ekzistuese, të cilën e kam korrigjue sepse kam gjetun gabime të shkaktueme nga mosanaliza e mirë e burimeve primare ose nga qëllime politike.

Kam pasë kujdes edhe që rezultatet e studimeve të mija t'i popullarizoj, me aq sa më lejohej, në botime në vete ose ndër të përkohëshme e gazeta të ndryshme.

Prandaj, bibliografinë time të kohës që kam punue në Sektorin e Mesjetës, e kam dallue në dy grupe: a) Studimore; b) Popullarizuese.

## A – Bibliografi studimore

### 1 – Botime studimore në fushën e Historisë Politike

*Lëvizja e Leshit edhe ekspedita e Skanderbegut të Ri (1499-1506)*, Buletini për Shkencat Shoqërore, 1953, nr. 4, fq. 11-30

*Luftat e popullit shqiptar kundër pushtimit turk në vjetët 1479-1492*, Bul. Shk. Shoq., 1956, nr. 1, fq. 76-95.

*Projektet shqiptare për çlirimin e vendit drejtue Evropës në vjetët 1577-1621*, Bul. Shk. Shoq., 1956, nr. 4, fq. 116-132.

*Bashkimi i Maleve shqiptare në fillim të shekullit XVII-të – Ekspedita e Vuço Pashës mbi Kelmend më 1638*, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria për Shkencat Shoqërore, 1957, nr. 1, fq. 63-95.

*Lëvizja shqiptare në kohën e ekspeditës së Karlit VIII n'Itali (1494-1495)*, Bul. Univ. Sht., 1957, nr. 2, fq. 111-121.

*Disa fletë të historisë së Shqipnisë në periudhën 1506-1574*, Bul. Univ. Sht., 1960, nr. 2, fq. 3-25.

*Randësia ndërkombëtare e Kuvendeve shqiptare në kalim prej shekullit XVI në të XVII-tin*, Bul. Univ. Sht., 1962, nr. 4, fq. 140-152 – ribotue në “Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike”, Tiranë 1965, fq. 498-505 – botue në përkthimin italisht (me gabime në ndonjë rast rranjësores) në: “Rassegna di Studi Albanesi”, nr. 1, 1963, fq. 101-109.

*Kontribut për Historinë e Shqipnisë bregdetare në fillim të shek. XVI – Lezhja, Rodoni, Durrësi dhe përpjekjet e fundit për rimëkambjen e principatave shqiptare*, Studime Historike, 1964, nr. 1, fq. 95-123.

*Shënime mbi disa çashtje të Lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk*, Stud. Hist., 1965, nr. 1, fq. 149-155.

*Aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare në shekujt e parë të pushtimit otoman veçanërisht në vjetët 1593-1620*, Stud. Hist., 1967, nr. 3, fq. 113-128.

*Emni dhe tradita e Skënderbeut në përpjekjet e Shqiptarëve për liri gjatë shekujve të parë të pushtimit otoman*, Stud. Hist., 1967, nr. 4, fq. 93-104.

*Rëndësia ndërkombëtare e kryengritjeve shqiptare kundër pushtimit otoman – Nga një dokument i pabotuar i vjetit 1567, Stud. Hist., 1970, nr. 2, fq. 167-201.*

## 2 – Vëllimet e botimeve Dokumentare për Historinë e Shqipnisë me parathënie studimore

*RELACIONE mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII*

Vëllimi I (1610-1634), Tiranë 1963, fq. 1-538.

Vëllimi II (1634-1650), Tiranë 1965, fq. 1-525.

*DOKUMENTA të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë*

- pjesa e parë (1479-1499), Tiranë 1967, fq. 1-309.

- pjesa e dytë (1499-1506), Tiranë 1979, fq. 1-559.

*REGJISTRI i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417,*

Tiranë 1977, fq. 1-499.

*DOKUMENTE të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë*

- vëllimi i parë (1507-1592), Tiranë 1989, fq. 1-490.

- vëllimi i dytë (1593-1602), Tiranë 1990, fq. 1-387.

- vëllimi i tretë (1603-1621), Tiranë 1989, fq. 1-465.

- vëllimi i katërt (1675-1699), bashkëautor me Selami Pulahën, Tiranë 1990, fq. 1-569.

*DOKUMENTE për Historinë e Shqipërisë të shek. XV, bashkëautor me Luan Malltezin, vëllimi i parë (1400-1405), Tiranë 1987, fq. 1-712.*

## 3 – Përmbledhje e studimeve historike

*Përpyekjet e Shqiptarëve për liri në dy shekujt e parë të pushtimit otoman, N.Sh.B. "Naim Frashëri", Tiranë 1962, fq. 1-125.*

*Bashkëpunëtor në tekstet e historisë për periudhën e pushtimit otoman.*

## 4 – Marrëdhëniet feudale

*Shënime mbi një lëvizje fshatare në Shqipëri më 1607, Bul. Univ. Sht., 1961, nr. 1, fq. 135-147.*

*Diskutim rreth kumtesës së Z. Shkodrës "Të dhana të reja mbi legjislacionin e esnafëve në Shqipëri gjatë qindvjeçarit XVI-XVII", Konf. e parë e Stud. Alb.- Tiranë 15-21 Nëntor 1962, Tiranë 1965, fq. 664-665.*

*Disa të dhana për qytetin e Shkodrës në tridhetëvjetorin e parë të pushtimit otoman, Stud. Hist., 1966, nr. 3, fq. 47-60.*

*Të dhana mbi potencialin ekonomik të një shtëpie feudale shqiptar në shekullin XV – me dokumentin origjinal të zbuluem në familjen e Kolë Kamësit, Stud. Hist., 1979, nr. 2, fq. 175-198.*

*Autonomitë e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve, Stud. Hist., 1980, nr. 3, fq. 169-187.*

## 5 – Studime mbi burimet e reja dokumentare

*Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për Historinë e Shqipërisë, Bul. Shk. Shoq., 1955, nr. 3, fq. 122-130.*

*Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike dhe shoqnore të shekullit XVII – Relacioni i Frang Bardhit mbi Zadrimën dhe regjesti i 72 dokumentave të rij, Bul. Shk. Shoq., 1956, nr. 2, fq. 157-198.*

*Relacioni i Pjetër Budit drejtue kardinalit Gozzadino me 1621, Bul. Univ. Sht., 1958, nr. 2, fq. 79-92.*

*Mbi disa materiale të reja dokumentare të shek. XVII – Relacioni i Frang Bardhit mbi Pukën, Bul. Univ. Sht., 1958, nr. 3, fq. 170-215.*

*Rindërtimi i Mbishkrimit të Arbërit dhe mundësitë e reja për leximin e tij, Iliria, 1984, nr. 2, fq. 207-218.*

#### 6 – Studime në fushën e sociologjisë

*Dukagjini dhe Pulti në gjysmën e parë të shekullit XVII – Të dhana mbi diferencimin shoqnor – Bul. Univ. Sht., 1959, nr. 1, fq. 3-20*

*Pozita shoqnore e grues malësore shqiptare sipas kanunit, Bul. Univ. Sht., 1961, nr. 2, fq. 101-132.*

#### 7 – Në fushën e kritikës historike

*Angelo Tamborra, Gli Stati Italiani, l'Europa e il problema turco dopo Lepanto (Shtetet italiane, Evropa dhe problemi turk pas Lepantit), Firenze, Leo S. Olschki edit. MCMLXI – Biblioteca dell'Archivio Storico Italiano, XIII, pp. 1-94, St. Hist., 1964, nr. 2, fq. 231-234 – Studia Albanica, 1964, nr. 1, fq. 257-261, italisht.*

*Bistra Cvetkova, Mouvements antifeudaux dans les terres bulgares sous domination ottomans du XVI au XVII s. (Lëvizje antifeudale në tokat bullgare nën pushtimin otoman nga shek. XVI në të XVII-in) – Études historiques à l'occasion du XII-e Congrès International des Sciences Historiques, Vienne, août et septembre 1965, Tome II, Sofia 1965, fq. 149-168, Stud. Hist., 1966, nr. 1, fq. 159-164.*

#### 8 – Nismëtarët e Letërsisë Shqipe të inkuadruem në Lëvizjet çlirimtare

*Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit, Bul. Shk. Shoq., 1954, nr. 3, fq. 39-56.*

*Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit – Letra drejtue me 1621 kardinalit Gozzadino, Bul. Univ. Sht., 1958, nr. 2, fq. 67-94.*

*Diskutim rreth kumtesës së prof. Selman Rizës “Dy versionet e veprës së Pjetër Bogdanit”, në Konferencën Albanologjike 1962, Konf. e parë e St. Alb. – 15-21 Nëntor 1962, Tiranë 1964, fq. 401-403.*

*Diskutim për kumtesën e prof. Mahir Domit “Rreth Autorit dhe kohës së dorëshkrimit elbasanas me shqipërim copash të Ungjillit”, në Konferencën Albanologjike 1962, Konf. e parë etj., Tiranë 1965, fq. 399-400.*

*Shënime rreth disa të dhanave mbi Bibliografinë e Letërsisë shqipe të vjetër. Bul. Univ. Sht., 1963, nr. 1, fq. 233-237.*

*Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin, Bul. Univ. Sht., 1963, nr. 2, fq. 199-207.*

*Pjetër Mazrreku dhe Fjalorthi i tij i vjetit 1633, Studime Filologjike, 1964, nr. 2, fq. 167-174 – Studia Albanica, 1964, nr. 2, fq. 129-136.*

*Barleci apo Bardheci?, Stud. Fil., 1970, nr. 3, fq. 171-177.*

*Qëmtime për Budin e Bardhin, Stud. Hist., 1985, nr. 1, fq. 165-176.*

*Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në Letërsinë e Vjetër Shqiptare*, Stud. Fil., 1986, nr. 3, fq. 185-204.

9 – Përpyjekje për alfabetin, gjuhën shqipe dhe për arsim

*Zbulimi i një dokumenti të vjetër shqip*, 1948, nr. 2-3, fq. 79.

*Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit elbasanas*, Bul. Inst. Shk., 1949, nr. 1, fq. 55-57.

*Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit – transliterim, transkriptim dhe koment*, Bul. Inst. Shk., 1951, nr. 3-4, fq. 64-131

*Një dorëshkrim bektashjan i gjysmës së dytë të shek. XIX*, Bul. Shk. Shoq., 1955, nr. 4, fq. 203-210.

*Kontribut për historikun e alfabetit tonë*, Bul. Shk. Shoq., 1957, nr. 1, fq. 184-200

*Elemente të vetëdijes shqiptare në përpjekjet për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shekujt XVI-XVII*, Stud. Hist., 1965, nr. 3, fq. 37-59

*Letër në redaksi – Rreth disa formulimeve të gabueme në artikullin "Elemente të vetëdijes shqiptare për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shek. XVI-XVII, "Studime historike", 1965, nr. 3, fq. 37-59, Stud. Hist., 1967, Nr. 2, fq. 195-199.*<sup>572</sup>

10 – Të ndryshme

*Gjurmime në toponiminë historike – Rogozhinë-Raguzin?*, Bul. Univ. Sht., 1963, nr. 4, fq. 77-82

*Pashko Vasa, Burgimi im – Episod historik, 1850, e përktheu nga italishtja dhe e pajisi me fjalë hyrëse dhe shënime, Injac Zamputi*, në Pashko Vasa, Vepra letrare, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1987, fq. 135-293.

11 – Esë-kritike

*Eskursion në dy vepra të Kadaresë: 1 – Ekskursion në librin "Autobiografia e popullit në vargje"; 2 – Ekskursion në librin "Eskili, ky humbës i madh"*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 1993, fq. 1-235

*Fishta – koha, njeriu, vepra*, Shtëpia botuese Pasqyra, Tiranë 1993, fq. 1-175.

## **B – Botimet me karakter popullarizues**

Para se të demaskohej ideologjia ime, në pranverën e vitit 1968, çdo organ (me përjashtim të "Zërit të Popullit") më kërkonte shkrime. Kam regjistruar vetëm disa.

*Si e njoha unë Ndre Mjedën*, Revista Nëndori, viti VIII, nr. 8, gusht 1960, fq. 203-214.

---

<sup>572</sup> Mbas kritikave kundër ideve të autorit që arritën kulmin me mbledhjet e fletë-rrufetë e shumta kundër tij në periudhën e "revolucionarizimit" 1966-67, autori detyrohet, më në fund, të përgjigjet me këtë "Letër në Redaksi". Për sqarimin më të mirë të lexuesve rekomandojmë kumtesën "Historia evropiane e Injac Zamputit" botuar në gazetën "Shekulli", Nr. 2878, 14 shkurt 2010, fq. 16-17, mbajtur nga Pëllumb Xhufi në përkujtimin e 100-vjetorit të lindjes së autorit (J.Z.).

*500-vjetori i dokumentit ma të hershëm të shkrimit shqip*, Gazeta Bashkimi, 9 nëndor 1962, fq. 3.

*Një pasardhës i Skënderbeut në krye të luftëtarëve shqiptarë në luftën e Klishit më 1596*, Gazeta Mësuesi, viti V, nr. 27(201), 2 korrik 1965, fq. 4.

*Koha dhe veprimtaria e Pjetër Budit (Me rastin e 400 vjetorit të lindjes)*, Rev. Nëndori, viti XIII i botimit, 1966, nr. 9, fq. 123-142.

*Randësia e lëvizjes së armatosun shqiptare më 1481, kur erdhi dhe u vu në krye të saj djali i Skënderbeut*, Gjoni, Gaz. Mësuesi, 21 prill 1967.

*Dokumenta dhe materiale për zhvillimin e luftës së Himarës më 1492*, Gazeta Zëri i Rinisë, 20 maj 1967.

*Në ç'rrethana historike ngjau ekspedita e Bajazidit të dytë në Shqipëri më 1492*, Gaz. Zëri i Rinisë, nr. 59(1954), e shtunë 15 korrik 1967, fq. 4 në 3 shtylla.

*Dëshmi e forcës së paepun të popullit shqiptar – Rrethimi i Krujës më 1467*, Revista 10 Korriku, 1967/VII.

*I biri i Skënderbeut, Gjon Kastrioti, dhe lëvizja e armatosur në Shqipëri më 1481 – Dokumenta dhe materiale*, Gaz. Zëri i Rinisë, e shtunë 13 gusht 1967.

*Ekspedita e Bajazidit të dytë më 1492 – dokumentacion*, Gaz. Zëri i Rinisë, 26 gusht 1967.

*Damjani Himariot – 25 korrik 1537*, Revista Ylli, gusht 1967.

Në pranverën e vitit 1968 po pregatitej demaskimi i im dhe punimi i fundit "*Lëvizja e armatosun shqiptare më 1494-1506 dhe ekspedita e Skënderbeut të Ri në Lezhë*" dorëzue për gazetën "Zëri i Rinisë" nuk u botue. Deri më 1987 nuk më lejohej botimi në organet e ndryshme. Në këtë vit (1987) m'u hap rruga për me botue studimet e mija në organet e ndryshme; edhe në gazetën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve "Drita".

*Fakte – mendime – gjykime, në librin e Pashko Vasës "Burgimi i im"*, Gazeta Drita, viti XXVII, 25(1389), 14 qershor 1987, fq. 12 (Për këtë artikull mora çmimin e tretë)

*Kumtesë për një shtatëdhjetëvjetor të ndritur – Më 1917, në kuadrin e veprimtarisë së Komissisë Letrare shqipe, hapet shkolla e parë laike për vajzat në Shkodër*, Gaz. Drita, viti XXVII, 38(1402), 13 shtator 1987, fq. 12.

*Fjala e shkruar e bën edhe më dëshmues objektin arekologjik – Dy rezultate të rëndësishme të arkeologjisë dhe të epigrafisë*, Gaz. Drita, viti XXVIII, 3(1420), 17 janar 1988, fq. 12.

*As roman, as legjendë historike, por histori legjendare – Për jetën dhe luftat e kelmendasve*, Gaz. Drita, viti XXVIII, 21(1438), 22 maj 1988, fq. 12.

*Në emër të lirisë: përballë sulltanit dhe perandorit*, Gaz. Drita, viti XXVIII, 28(1445), 10 korrik 1988, fq. 12.

*Pjetër Bogdani – luftëtar në të gjitha frontet për idealin shqiptar*, Gaz. Drita, viti XXIX, 10(1479), 5 mars 1989, fq. 12.

*Rubrika "Punëtorë të penës, burra të aksionit": Buzuku, Meshari dhe Pasthënia*, Gaz. Drita, viti XXIX, 20(1498), 16 korrik 1989, fq. 12.

*Poeti përketthen poetin – Skicë në formë të një kritike*, Gaz. Drita, viti XXIX, 37(1506), 10 shtator 1989, fq. 12.

*Marin Barleti dhe vepra e tij madhore*, Gazeta Drita, 25 Nëntor 1990, fq. 7 dhe 11

Botime në revistën “Hylli i Dritës” në vitet ‘90

*Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe* – Hylli i Dritës, 1995, Nr. 1-2, fq. 14-51.

*Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me principatën e Arbërit* – H. Dr., 1995, Nr. 5-6, fq. 16-29.

*Mbi disa fjalë të kristalizueme në lutjet e në praktikën fetare katolike* – H. Dr., 1996, Nr. 1-2, fq. 9-17.

*Valbona – argumente dhe dëshmi në lidhje me prejardhjen e këtij toponimi* – H. Dr., 1996, Nr. 3-4, fq. 68-79.

*Portreti i Fishtës në objektivin tim* – H. Dr., 1996, Numër i posaçëm, fq. 24-28.

*Mirësetëvijë në konak të vet Fishta, i mërguar ...* - H. Dr., 1996, Numër i posaçëm, fq. 256-276.

*Përsaktësime në toponiminë me fiset përkatëse n’aksionin kolonizues të Dionisit e në luftat Iliro-Romake* – H. Dr., 1997, Nr. 1-2, fq. 25-49.

*Regesti Kamsi* – H. Dr., 1997, Nr. 5-6, fq. 70-95 (**Shënim:** Ky është punimi i fundit që ka botuar kur ishte gjallë. Punimet e mëposhtme janë botuar nga dorëshkrimet e lëna – **J.Z.**).

*Kujtime për Dom Ndre Mjedjen* – H. Dr., 2011, Nr. 2, fq. 122-141.

*Gjon Kolë Kujxhija* – H. Dr., 2011, Nr. 3, fq. 131-136.

*Kronika e Shkodrës 1831-1839* – H. Dr., 2011, Nr. 4, fq. 69-84 (**Shënim:** Është botuar me emrin e autorit të kronikës, Zef Bubçi, dhe vetëm përkthimi e shënimet pa origjinalin e transkriptuar, me gjithë se redaksisë iu dërgua e plotë – **J.Z.**).

*Çashtja e kombësisë në shekullin e XVII-të* – H. Dr., 2012, Nr. 2, fq. 49-52

*Shënime për fazën përfundimtare të lëvizjes shqiptare dhe të ekspeditës së Gjon Kastriotit më 1481* – H. Dr., 2013, Numër jubilar me rastin e 100-vjetorit të themelimit, fq. 277-300.